



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



SHQYRTIM I POLITIKËS AKTUALE TË TARIFAVE UNIFORME PËR SHËRBIMET E UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË

RASTI NR 10832.00 (SDC RWSSP V)

Verzioni Final O i aprovuar

Korrik 2015

**SHQYRTIM I POLITIKËS AKTUALE TË
TARIFAVE UNIFORME PËR SHËRBIMET E
UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË**

RASTI NR10832.00 (SDC RWSSP V)

Personat kontaktues
Graham Cleverly/ Vera Muhaxhiri

E-Mail: graham@cleverly.co.uk
vera.muhaxhiri@gmail.com

DETAJET E PROJEKTIT

Projekti:	Mbështetje e Ekspertëve për Zyrën Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) në Kosovë
Përfituesi:	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK)
Autoriteti Kontraktues:	Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim e përfaqësuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran (ZBZ) në Kosovë
Raporti:	SHQYRTIM I POLITIKËS AKTUALE TË TARIFËS UNIFORME PËR SHËRBIMET E UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË
Kontrata nr:	RASTI NR10832.00 (SDC RWSSP V)
Kontraktori:	Skat Consulting Ltd. Vadianstr. 42, CH-9000 St.Gallen, Sëitëzland
Emri i mandatarit ndihmës: Konsulenti:	Florian Klingel
Konsulentët:	Graham Cleverly Vera Muhaxhiri

PËRMBAJTJA

DETAJET E PROJEKTIT	1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1 HYRJE	8
1.1 Sfondi	8
1.2 Termat e Referencës	8
1.3 Takimet	9
1.4 Falenderimet	10
2 KORNIZA KUSHTETUESE, POLITIKE DHE LIGJORE NË KOSOVË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË UJËRAVE TË ZEZA	11
2.1 Hyrje	11
2.2 Dispozitat kushtetuese dhe politike	11
2.2.1 Kushtetuta e Kosovës	11
2.2.2 Politika e Ujërave të Kosovës	11
2.2.3 Strategjia e Ujërave të Kosovës	12
2.2.4 Politika Tarifore për Ujë dhe Ujëra të Zeza e ZRRUK	12
2.2.5 Fletët për Dialogun e Politikave	13
2.3 Legjislacioni përkatës për Ujë dhe Ujëra të Zeza në Kosovë	14
2.3.1 Legjislacioni Primar	14
2.3.2 Legjislacioni Sekondar	15
3 TARIFA UNIFORME/ LOKALE DHE PARIMI NDOTËSI PAGUAN	16
3.1 Perspektiva Globale	16
3.1.1 Tarifa Uniforme Kundrejt asaj Lokale	16
3.1.2 Parimi Ndotësi Pagan	16
3.2 Perspektiva Rajonale	17
3.2.1 Tarifat Uniforme kundrejt atyre lokale	17
3.2.2 Ndikimi Mjedisor dhe Nivelet e Shërbimeve të Konsumatorit	19
3.2.3 Parimi Ndotësi Pagan	20
4 TARIFAT UNIFORME PËR PELLGJET LUMORE	23
4.1 Hyrje	23
4.2 Konsolidimi	23
4.3 PNP	23
4.4 Tarifat Uniforme për Pellgjet Lumore	23
4.5 Konkluzione	24
5 SHQYRTIMI DHE ANALIZA E STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT TË ITUZ LIDHUR ME PËRBALLUESHMËRINË E TARIFAVE	25
5.1 Hyrje	25

5.2	Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në 5 Kompanitë Rajonale të Ujit: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj	25
5.3	Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në Rajonin e Pejës	26
5.3.1	Pse zgjedhet SF i Pejës si shembull?	26
5.3.2	Zhvillimi i tarifave	26
5.3.3	Përballueshmëria	28
5.3.4	Pranimi Socio-Kulturor dhe Gatishmëria për të Paguar	30
5.4	Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në Rajonin e Gjakovës	31
5.5	Rritja e Ndërgjegjësimit Publik për Çështjet e Ndotjes Mjedisore	31
5.5.1	Hyrje	31
5.5.2	Masat për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik	31
6	PËRMBLEDHJE E PËRVOJËS ME POLITIKËN TARIFORE TË UJËRAVE TË ZEZA NE VENDET TJERA RAJONALE DHE MËSIMET E NXJERRA	34
6.1	Hyrje	34
6.2	Shqipëria	34
6.3	Bosnja dhe Hercegovina	36
6.4	Maqedonia	37
6.5	Mësimet e nxjerra për përvojën rajonale të tarifave të ujërave të zeza	37
7	KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME	39
7.1	Konkluzionet	39
7.2	Rekomandime të përgjithshme	40
7.3	Rekomandimet Lidhur me Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik	41
	SHTOJCA A: ABSTRAKT I TER	43
	SHTOJCA B: FLETA E POLITIKËS SË DIALOGUT PËR TARIFAT UNIFORME RAJONALE TË UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË	46
	SHTOJCA C: FLETA E DIALOGUT TË POLITIKËS PËR TARIFËN E SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA	48
	SHTOJCA D: TARIFAT E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË NDËRMARRJET E UJËSJELLËSIT NË SHQIPËRI: 2014	50
	SHTOJCA E: PJESËMARRËSIT E TAKIMIT TË TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT TË DATËS 23 QERSHOR 2015	51

SHKURTESAT

Akronimi	Përshkrimi i plotë
APL	Autoriteti i Pellgjeve Lumore
KE	Komisioni Evropian
EUR	Euro
QK	Qeveria e Kosovës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KNMU	Këshilli Ndërmintor i Ujërave
IKShP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
O+M	Operative dhe mirëmbajtje
e.b.	Banorë ekuivalent
PNP	Parimi Ndotësi Pagan
PMPL	Planet Menaxhuese të Pellgjeve Lumore
KRU	Kompania e Rajonale e Ujit
ZBZ	Zyra e Bashkëpunimit Zviceran
ZZKB	Zyra Zvicerane për Koordinim dhe Bashkëpunim
SECOSECO	Sekretarati i Shtetit për Çështje Ekonomike
SKAT	Qendra Burimore Zvicerane për Konsultimet për Zhvillim
SHUKOS	Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimeve të Kosovës
DUZU	Direktiva e Ujërave të Zeza Urbane
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ERRU	Enti Rregullator i Ujit (i Shqipërisë)
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësllës dhe Kanalizim
ITUZ	Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport final (verzioni O) përmbledh aktivitetet kryesore studimore të ndërmarra në Mars dhe në Prill të vitit 2015 për shqyrtimin e politikës ekzistuese të tarifës uniforme për shërbimet e ujërave të zeza në Kosovë dhe prezanton gjetjet dhe rekomandimet finale përfshirë edhe komentet e dobishme të pranuar nga palët e interesit gjatë diskutimit në takimin e tryezës së rrumbullakët për palët e interesuara në datën 23 Qershor 2015 në Prishtinë.

Lista e palëve të interesuara të cilët kanë marr pjesë në takimin e tryezës së rrumbullakët të datës 23 Qershor 2015 është dhënë në Shtojcën E.

Struktura e Raportit

Kapitujt në këtë raport mbulojnë detyrat kryesore siç janë të përcaktuara në Termat e Referencës si në renditjen e mëposhtme:

Kapitulli 0:	Përmbledhja Ekzekutive
Kapitulli 1:	Sfondi/ Termat e Referencës/ Takimet e mbajtura/ Falenderimet
Kapitulli 2:	Kushtetuta, Politikat dhe Legjislacioni për vendosjen e tarifave për ujërat e zeza në Kosovë
Kapitulli 3:	Tarifa Uniforme kundrejt asaj Lokale dhe Parimi Ndotësi Pagan
Kapitulli 4:	Qasja sipas pellgjeve lumore e tarifave uniforme
Kapitulli 5:	Shqyrtimi i studimeve të fizibilitetit për impiantet e trajtimit të ujërave të zeza në lidhje me përballueshmërinë e tarifës së ujërave të zeza
Kapitulli 6:	Përmbledhja e përvojës me politikën e tarifës së ujërave të zeza në vendet rajonale duke përfshirë çdo mësim të nxjerrë
Kapitulli 7:	Konkluzionet dhe Rekomandimet finale

Përkufizimi i Tarifës Uniforme

Një "politikë e tarifës uniforme" për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza nënkupton se ekziston një strukturë e konsoliduar për të ngarkuar konsumatorët për ato shërbime, përmes së cilës strukturë kostot aktuale për ofrim të shërbimit paraqiten si një mesatare në të gjithë zonën e shërbimit. Në rastin specifik të tarifave uniforme për shërbimet e ujërave të zeza në Kosovë, nënkuptohet që konsumatorët të cilët shërbehen aktualisht nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) e ofruar nga Kompania Rajonale e Ujit, por që aktualisht janë të vendosur jashtë zonës së shërbimit të planifikuar të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza të Kompanisë Rajonale të Ujit, do ngarkohen për kostot e trajtimit të ujërave të zeza përmes aplikimit të tarifës uniforme në përputhje me Politikën Tarifore aktuale të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (Nr. 5).

Konsumatorët pa Qasje

Konsumatorët në Kosovë të cilët **nuk** shërbehen nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) të Kompanisë Rajonale të Ujit specifikisht përjashtohen nga pagesa për shërbimet e ujërave të zeza me Politikën Tarifore të ZRRUK Nr. 4 për shkak se ata nuk pranojnë "shërbime të ujërave të zeza". Aplikimi i Parimit Ndotësi Pagan tek këta konsumatorë përmes zbatimit të marrëveshjes së "tarifës së shkarkimit" do diskutohet shkurtimisht më vonë në raport, në -sesionin 3.2.3.

Përmbledhja e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Kryesore

Pas konsultimit me një gamë të gjërë të palëve të interesuara në Kosovë dhe më tepër pas diskutimit të gjetjeve dhe rekomandimeve finale me palët e interesit në takimin e tryezës së rrumbullakët duket se ekziston një pajtim i përgjithshëm që qasja ekzistuese e tarifës uniforme (në përputhje me Politikën e Ujërave të Kosovës dhe me Politikën Tarifore për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim), gëzon një përkrahje të gjërë nga palët e interesuara dhe është qasja e politikës tarifore më e përshtatshme për ujëra të zeza për disa arsye:

- Nuk është diskriminuese për konsumatorët, në cilëndo Kompani Rajonale të Ujit, që marrin shërbimet e njëjta të ujërave të zeza;
- Është në pajtueshmëri me Parimin Ndotësi Pague;
- Është në pajtueshmëri me sesionet e Politikës së Ujërave të Kosovës dhe kërkesat aktuale të Politikës Tarifore të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim;
- Rezulton në tarifa të përgjithshme më të ulta të ujërave të zeza krahasuar me tarifatat lokale;
- Shpërndan kostot operative dhe të mirëmbajtjes të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza tek të gjithë konsumatorët e lidhur në kanalizimet e Kompanive Rajonale të Ujit, e cila ndihmon në lehtësimin e çështjeve të përballueshmërisë për familjet me të ardhura të ulëta;
- Shmang rritjet e mëdha të tarifave lokale sa herë që nevojiten investime kapitale për renovime apo përmirësime;
- Arrin stabilitetin e të ardhurave;
- Zvogëlon kostot administrative për aktivitetet e Kompanisë Rajonale të Ujit dhe Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim gjatë periudhës së përcaktimit të tarifave;

Megjithatë, janë disa mësimet të dobishme për tu mësuar, sidomos nga përvoja e tarifave të ujit dhe ujërave të zeza të Shqipërisë p.sh. përfitimet e rritjes graduale të tarifës.

Përveç kësaj, janë disa çështje shumë të rëndësishme, "të ndjeshme", të cilat duhet të adresohen urgjentisht p.sh. angazhimi efektiv i konsumatorëve të secilës Kompani Rajonale të Ujit për çështjet e tarifës së ujërave të zeza, rritjen e ndërgjegjësimit publik për çështjet e Parimit Ndotësi Pague nga Qeveria Qendrore, dhe nevojën për të marrë parasysh subvencionet qeveritare për familjet me të ardhura të ulëta, etj.

Rekomandimet e Përgjithshme

Ky raport rekomandon masat e mëposhtme në lidhje me çështjet e politikës tarifore të ujërave të zeza dhe përballueshmërisë/ gatshmërisë për të paguar-pas diskutimeve të dobishme me palët e interesuara në takimin e tryezës së rrumbullakët:

1. **Vazhdimi me politikën ekzistuese tarifore për ujë dhe ujëra të zeza në formën aktuale siç përcaktohet në Politikën Tarifore të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim Nr. 5 ("tarifat uniforme për shërbimet e ujit dhe ujërat e zeza për të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e kanalizimit të Kompanisë Rajonale të Ujit").**
2. Marrja në konsideratë e qasjes sipas pellgjeve lumore të tarifave uniforme për ujërat e zeza të jenë pjesë e konsolidimit të mëtejshëm të shtatë Kompanive Rajonale të Ujit, në 3 ose 4 kompani më të mëdha rajonale, në një afat të mesëm.

3. Ngritja e vetëdijësimit dhe të kuptuarit e Parimit Ndotësi Pague me qytetarët në Kosovë përmes një fushate të koordinuar nga Qeveria Qendrore dhe Lokale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kompanitë Rajonale të Ujit dhe Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, me përkrahje nga donatorët kryesor të sektorit të ujit, në mënyrë që të ndihmohet adresimi i mungesës së gatishmërisë për të paguar tarifa shtesë për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza (veçanërisht nga konsumatorët të cilët janë të lidhur në kanalizimin e Kompanisë Rajonale të Ujit por jo të lidhur në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza).
4. ZRRUK të marr në konsideratë lejimin e rritjes graduale të tarifave të ujërave të zeza përpara se të bëhet pranimi i FTUZ, por vetëm pasi që KRU relevante të demostrojnë përmirësime të qëndrueshme të performancës së tyre kundrejt caqeve specifike të aprovuara nga ZRRUK (p.sh. zvogëlimi i UPF, përmirësimi i efikasitetit të arkëtimit, No. i çkyçjeve të konsumatorëve ilegal etj.) si gjë e nevojshme për aprovimin e tarifave rritëse të ujërave të zeza.
5. ZRRUK të zhvillojë masat për të nxitur Kompanitë Rajonale të Ujit të përmirësojnë performancën e tyre duke u bazuar në atë se konsumatorët në përgjithësi janë më të gatshëm të paguajnë tarifa më të rritura për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza nëse performanca e përgjithshme e kompanisë vazhdon të përmirësohet (një "rreth virtuoze").
6. ZRRUK dhe Enti Rregullator për Ujë të Shqipërisë duhet të vazhdojnë të mbajnë lidhjen për së afërmi dhe të ndajnë përvojat e tyre mbi çështjet e përbashkëta duke përfshirë tarifat e ujërave të zeza, përballueshmërinë dhe gatishmërinë për të paguar faturat, përfitimet për familjet me të ardhura të ulta dhe nivelet e grumbullimit të parasë së gatshme me prezantimin e bllok tarifave, aty ku rrethanat lejojnë.
7. Çështjet e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për trajtimin e ujërave të zeza dhe Parimi Ndotësi Pague duhet të ngriten nga iniciativa specifike - shihni sesionin 4.6.2.

1 HYRJE

1.1 Sfondi

Disa palë kyçe të interesit në Kosovë, duke përfshirë Zyrën Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK), së fundi kanë ngritur shqetësimet e tyre lidhur me popullatën që aktualisht shërbehen nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) të Kompanive Rajonale të Ujit (KRU) por janë të vendosur jashtë mbulimit të planifikuar fillestar të shërbimit të impianteve të reja për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ) në qytetet kryesore të Kosovës, të cilët mund të kundërshtojnë pagesat e rritura për shërbimet e ujërave të zeza në të ardhmen. Pagesa/ngarkesa të tilla të ujërave të zeza do aplikohen tek të gjithë konsumatorët e lidhur në kanalizim duke supozuar zbatimin e vazhdueshëm të tarifës uniforme për ujërat e zeza në përputhje me Politikën Tarifore aktuale të ZRRUK, Deklarata Nr. 5. Kjo në anën tjetër mund të ndikoj në objektivin e përgjithshëm për të rritur arkëtimin e të ardhurave dhe kështu të ndikoj në stabilitetin financiar të KRU, në veçanti me zhvillimin e sektorit të trajtimit të ujërave të zeza.

Duhet të theksohet se ata konsumatorë në Kosovë të cilët **nuk** shërbehen nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) e KRU janë të përjashtuar nga ngarkesa/pagesa për shërbimet e ujërave të zeza në Politikën Tarifore aktuale të ZRRUK Nr. 4, për arsyen se ata nuk pranojnë ndonjë "shërbim të ujërave të zeza". Zbatimi i Parimit Ndotësi Paguan tek këta konsumatorë përmes një marrëveshje të "pagesës së shkarkimit" diskutohet shkurtimisht në raport në sesionin 3.2.3. Pas zhvillimit të draft Termave të Referencës (TeR) për një shqyrtim të tarifës uniforme për shërbimet e ujërave të zeza nga sekretariati i Këshillit Ndërmnistror të Ujërave (K-NMU) në fund të vitit 2014, SKAT Consulting Ltd, të cilët ofrojnë shërbime ndihmëse për projektin RWSSP V duke përfshirë mbështetje për ZRRUK, janë mandatuar nga ZBZ për të marrë përsipër menaxhimin e shqyrtimit që përfshinë prokurimin e Shërbimeve të Konsulencës. Konsulentët që përbëhen nga një ekspert ndërkombëtar i sektorit të ujërave dhe një ekspert lokal financiar janë emëruar në fillim të Marsit 2015 dhe kanë filluar shqyrtimin në fund të Marsit 2015.

1.2 Termat e Referencës

Detyrat Kryesore

Detyrat/ qëllimet kryesore të shqyrtimit janë të përmbledhura më poshtë dhe përmbajtja e mëtejshme nga TeR është e ofruar në **Shtojcën A**:

- Analizimi i politikës dhe i legjislacionit për vendosjen e tarifave të trajtimit të ujërave të zeza në Kosovë;
- Shqyrtimi i studimeve relevante të fizibilitetit¹ për trajtimin e ujërave të zeza dhe ndërmarrja e krahasimeve analitike dhe ndikimi i përcaktimit të tarifës lokale kundrejtë asaj uniforme;
- Theksimi i përfitimeve dhe dëmeve të qasjes ekzistuese të tarifës uniforme duke përfshirë një analizë të përballueshmërisë dhe gatishmërisë për të paguar faturat

¹ Për të përfshirë Studimet e Fizibilitetit të SECO për Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Zeza për Gjakovë (2013) dhe Pejë (2014)

që rezultojnë nga zbatimi i qasjes së përcaktimit të tarifave uniforme të ujërave të zeza në të gjithë zonën e shërbimeve të KRU/pellgjeve lumore²;

- Një krahasim bazik i qasjeve të ndryshme të përcaktimit të tarifave të ujërave të zeza në rajon³ dhe përmbledhja e mësimave që do të nxjerren;
- Prezantimi i gjetjeve dhe draft rekomandimeve ⁴ në një tryezë të rrumbullakët në fund të detyrës dhe;
- Shkrimi i një Raporti Final të shkurtër (max 30 faqe plus Shtojcat) që përmbledh rezultatet e shqyrtimit dhe përfshinë rekomandimet kryesore.

Dokumentet kryesore që do dorëzohen:

Konsulentët do i raportojnë ZBZ përmes ekipit ndihmës të SKAT dhe do ofrojnë:

- Një draft raport dhe prezantim në Powerpoint, brenda 3 javëve të fillimit të detyrës, për diskutim dhe miratim në një mbledhje në tryezë të rrumbullakët e cila do mbahet në Prishtinë në mes të muajit Maj 2015;
- Një raport final brenda 2 javëve të tryezës së rrumbullakët pas përfundimit të kontratës, i cili përmban të gjitha gjetjet, elementet e prodhuara, konkluzionet dhe rekomandimet që rezultojnë nga puna e bërë;
- Dokumentin e Politikës së Tarifës për Ujë dhe Ujëra të Zeza të përditësuar (nëse është e nevojshme).

1.3 Takimet

Tabela e mëposhtme përmbledh një numër të takimeve të dobishme ballë për ballë me një numër të madh të palëve të interesuara në Kosovë dhe Shqipëri të mbajtura gjatë muajve Mars dhe Prill 2015, gjatë përgatitjes së këtij raporti:

Palët	Organizata	Data e takimit	Çështjet kryesore të diskutuara
Raif Preteni, Sami Hasani	ZRRUK	30/03/15	TeR, nevojat e studimit për tarifë uniforme të ujërave të zeza
Faruk Hajrizi	KRU Mitrovica	30/03/15	ITUZ Skënderaj.
Agron Tigani	KRU Hidrodrini	30/03/15	Përdatësim për ITUZ Pejë, çështjet tarifore
Christoph Lang, Ardiana Efendija-Zhuri	ZBZ, Prishtinë	1/04/15	TeR, nevojat e studimit të tarifave uniforme të ujërave të zeza, progresit, programit etj.
Premtim Islami	KfW	30/03/15	Mendimi i KfW për qasjen ndaj tarifës uniforme
Lulzim Paqarizi, Lum Sallahu	KRU Hidroregjioni Jugor	2/04/15	Përditësim për ITUZ Prizren, çështjet tarifore
Ismet Ahmeti,	KRU Radoniqi	2/04/15	Përditësim për ITUZ Gjakovë,

² Pas komenteve në draftin final të raportit dhe pas takimit të tryezës së rrumbullakët në Qershor 2015, kërkesat në TeR sa i përket qasjes sipas pellgjeve lumore janë qartësuar për të nënkuptuar një analizë të thjeshtë të anëve pozitive dhe negative të tarifave uniforme bazuar në kuptimin e tanishëm të situatës, e cila do të mjaftonte për këtë rishikim.

³ P.sh. për ITUZ Skënderaj, në Kosovë dhe ITUZ Durrës, në Shqipëri.

⁴ Përfshihen rekomandimet konkrete në mënyrën se si KRU dhe palët tjera duke përfshirë ZRRUK mund të përmirësojnë angazhimin e tyre me konsumatorët shtëpiak dhe të rrisin ndërgjegjësimin për çështjet e reduktimit të ndotjes së mjedisit duke u bazuar në Parimin që "Ndotësi Pague", në mënyrë që të adresohen çështjet kyçe të përballueshmërisë dhe gatishmërisë për pagimin e faturave që rezultojnë nga tarifa më të larta për shërbimet e ujërave të zeza.

Palët	Organizata	Data e takimit	Çështjet kryesore të diskutuara
Kastriot Zhaveli, Agron Tafarshiku			çështjet tarifore
Baton Begolli	KNMU	3/04/15	Politika e ujërave, strategjia e ujërave, strategjia e llymit, qasja e pellgjeve lumore, sfondi i përgjithshëm.
Ramadan Sejdiu, Sami Hasani	MZHE ZRRUK	3/04/15	KRU, ITUZ Skënderaj, çështjet e përballueshmërisë dhe vetëdijësimit publik
Shiqeri Dermaku, Hazir Çadraku Sami Hasani	MMPH ZRRUK	17/04/15	Përditësimi AI 06/200, ITUZ Skenderaj, çështjet e përballueshmërisë dhe vetëdijësimit publik
Eduart Rumani, Vehbi Duraku	ZBZ, Tirana ZRRUK	21/04/15	Mendimi i ZBZ mbi sektorët e ujit dhe ujërave të zeza, projektet - SECO/KfW në Shqipëri
Avni Dervishi, Silvana Simaku, Fatime Imeraj, Ina Haxhimusai, Vehbi Duraku	ERRU, Tiranë ZRRUK	21/04/15	Përvoja e Shqipërisë për tarifat uniforme të ujërave të zeza, bllok tarifit, çështjet institucionale, PNP

Shënim i rëndësishëm: Pa përjashtim, të gjitha palët e konsultuara në Kosovë dhe në Shqipëri gjatë përgatitjes së këtij raporti kanë qenë në përgjithësi ose përkrahëse të politikës aktuale të tarifës uniforme të ujërave të zeza ose nuk kanë pasur ndonjë mendim të vendosur pasi kjo çështje ka qenë jashtë përgjegjësisë së tyre.

Shënim: Disa prej KRU të konsultuara shprehën pakënaqësinë për mosgatishmërinë e ZRRUK për të pranuar tarifën e rritura të propozuara për shërbimet e ujërave të zeza në periudhën tarifore 3 vjeçare 2015-2017 para se të mandatohen ITUZ, ku qëllimi ishte që të zbutet rritja e përgjithshme e tarifave për një periudhë më të gjatë dhe të zvogëlohet reagimet e mundshme negative nga konsumatorët.

1.4 Falenderimet

Stafi kombëtar i ZBZ në Prishtinë (Ardiana Efendija-Zhuri) dhe në Tiranë (Eduart Rumani) së bashku me Këshilltarin Rajonal për Ujë dhe Mjedis (Frank Wiederkehr) me qëndrim në Maqedoni, kanë ofruar raporte dhe këshilla të dobishme mbi përvojën tarifore rajonale dhe kontributi e përkrahja e tyre për përgatitjen e këtij raporti vlerësohet shumë.

Përkrahja e dobishme dhe të dhënat e ofruara nga Drejtori i ZRRUK (Raif Preteni) dhe nga Shefi i departamentit të tarifave në ZRRUK (Sami Hasani) poashtu vlerësohen shumë.

Baton Begolli, sekretariati i KNUMU ka ofruar të rehat mbi politikën e ujërave dhe tjera çështje relevante gjatë përgatitjes së këtij raporti dhe ndihma e tij poashtu vlerësohet shumë.

Z. Avni Dervishi, Kryetari i Entit Rregullator të Ujit në Shqipëri dhe kolegët e tij ofruan këshilla të dobishme dhe konstruktive mbi përvojën e tarifave të ujërave të zeza në Shqipëri dhe përkrahja e ERRU poashtu vlerësohen shumë.

2 KORNIZA KUSHTETUESE, POLITIKE DHE LIGJORE NË KOSOVË PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË UJËRAVE TË ZEZA

2.1 Hyrje

Një përmbledhje e shkurtër e kornizës kushtetuese dhe e politikës përkatëse për çështjet e ujit dhe ujërave të zeza dhe çështjet e lidhura me ndotjen e mjedisit në Kosovë ofrohet më poshtë në sesionin 2.2. Përderisa dekretimi i masave legjislativë zakonisht ndjek zhvillimin e politikave të përshtatshme, në Kosovë zhvillimi i politikave dhe legjislacioni shpesh janë zhvilluar paralelisht, prandaj dokumenti i politikës së ujërave dhe dokumenti i strategjisë së ujërave janë aktualisht në fazën e draftit final.

Legjislacioni primar dhe sekondar relevant për çështjet e ujit dhe ujërave të zeza dhe çështjet tjera të lidhura me ndotjen e mjedisit janë të dhëna më poshtë në sesionin 2.3.

Sesionet përkatëse të dokumenteve të politikave të cituara më poshtë janë të theksuara me shkronja të zeza.

2.2 Dispozitat kushtetuese dhe politike

2.2.1 Kushtetuta e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita të qarta mjedisore duke përfshirë Nenin 7.1 i cili përcakton mbrojtjen e mjedisit si një nga dispozitat bazë për rendin kushtetues të Kosovës.

2.2.2 Politika e Ujërave të Kosovës

Politika e Ujërave të Kosovës është aprovuar para pak kohësh nga QeK. Sesioni përkatës në politikën për tarifën dhe kërkesat e efikasitetit qartazi kërkon që tarifën për shërbimet e ujit dhe ujërat e zeza të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të ofruesit të shërbimeve (dhe në mënyrë ideale në të gjithë pellgun e duhur të lumit), përsëritet më poshtë:

Deklarata e Politikës: Pritjet e efikasitetit dhe tarifës

- *Qeveria pret që ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë efikasitetin e tyre operacional. Për këtë, ne presim që korniza rregullatore të jetë e bazuar në pritshmëritë e përmirësimit të vazhdueshëm të efikasitetit, por në përputhje me rritjen e arsyeshme të tarifave, për të siguruar që kompanitë mund të mbështeten në rritjen e vlerës së investimeve të nevojshme nga burimet e tyre vetjake, sesa të mbështeten në donacione, dhe të kenë fitime të arsyeshme nga investimi i kapitalit. Ne kërkojmë nga ZRRUK që në kuadër të sistemit të përcaktimit të tarifave të aplikojë mekanizma që shpërblejnë përmirësimet në efikasitet.*
- *Tarifat duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të ofruesit të shërbimit. Kjo vlenë poashtu për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza pavarësisht se ku trajtohen ujërat e zeza brenda zonës së shërbimit, bazuar në principin "ndotësi paguan". Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit duhet të vlerësojë mundësinë e tarifave uniforme të ujërave të zeza në nivel të pellgut.*

2.2.3 Strategjia e Ujërave të Kosovës

Strategjia e Ujërave të Kosovës është në fazën e draftit final (versioni 2.2). Në disa vende strategjia i referohet Parimit Ndotësi Paguan kryesisht kur është në lidhje me shërbimet e ujësjellësit. Strategjia në sesionin 3.4.3 e pranon plotësisht që *për secilën kategori të konsumatorëve (ujë dhe ujëra të zeza) tarifat janë uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të KRU.*

2.2.4 Politika Tarifore për Ujë dhe Ujëra të Zeza e ZRRUK

Tarifat uniforme rajonale të ujit dhe ujërave të zeza janë një politikë e integruar brenda kornizës së përgjithshme të përcaktimit të tarifave të Politikës Tarifore të ZRRUK për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza, dhe në mënyrën e tyre aktuale që nga Dhjetori 2008. Përdatësimi pasues i Politikës Tarifore për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Ujërave të Zeza i ZRRUK në Mars 2011 ka ruajtur të njëjtin drejtim të politikës duke përfshirë nevojën për tarifat uniforme të ujit dhe ujërave të zeza në gjithë zonën e shërbimit të KRU. Deklaratat e Politikës aktuale të ZRRUK Nr. 4, 5, 16 dhe 17 janë të përsëritura më poshtë me vetë politikën, të paraqitura në një kuti.

Deklarata e Politikës së Ujit dhe Ujëra të Zeza Nr.5 "Unifikimi i Tarifave"

"Edhe pse kostot e shërbimeve përbrenda zonës së shërbimit të një ofruesi të shërbimeve ka të ngjarë të ndryshojnë sipas sistemit dhe qytetit, nuk është praktike (pa sistemet e ndërlukuara të kontabilitetit) të përcaktohen tarifa të veçanta për secilën zonë. Si pasojë e kësaj, tarifat duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e mbuluar me shërbime nga ofruesi i shërbimit. Nëse megjithatë, adoptohet një zonë e re ose një komunë e re nga ofruesi i shërbimit që ka një tarifë aktuale më të ulët se tarifa aktuale e ofruesit të shërbimit, rregullimi i tarifës së ofruesit të shërbimit mund të ketë nevojë të shpërndahet gjatë disa viteve e kjo për të shmangur çmimet befasuese".

Tarifat duhet të jenë uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të ofruesve të shërbimit përpos në rastet kur zona të reja të shërbimit janë adoptuar nga ofruesi i shërbimit dhe tarifat duhet të ngriten për t'i unisuar tarifat aktuale të ofruesit të shërbimit e në të cilin rast do të ishte e përshtatshme një rritje progresive (jo më shumë se gjatë tre viteve).

Deklarata e Politikës së Ujit dhe Ujërave të Zeza Nr. 4 "Strukturat tarifore të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza"

"Tarifat për furnizimin me ujë përbëhen nga tarifa fikse dhe tarifa volumetrike bazuar mbi konsumin e matur të furnizimit me ujë. Konsumatorët të cilët nuk pranojnë shërbime të ujërave të zeza nuk duhet të ngarkohen për shërbimet në fjalë. Tarifat për shërbimet e ujërave të zeza do të përcaktohen në bazë të vëllimit të shitur përveç kur një konsumator është i kyçur në rrjetin e ujërave të zeza por jo edhe në rrjetin e furnizimit me ujë (ose ka një burim shtesë të vetin të furnizimit me ujë) e në të cilin rast do të aplikohet ngarkesa e bazuar në gjenerimin e vlerësuar apo të matur të ujërave të zeza. Në të ardhmen tarifat për ujërat e zeza mund të përfshijnë dispozita për cilësinë e efluentit të gjeneruar përmes formulës Mogden ose ekuivalentit të saj"

Tarifat për furnizim me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza do të përcaktohen në bazë të volumit të shitur të ujit përpos nëse shfrytëzuesi i shërbimeve të ujërave të zeza furnizohet vetë me ujë, e në të cilin rast do të aplikohen ngarkesa bazuar në gjenerimin e vlerësuar të ujërave të zeza.

Konsumatorët të cilët nuk pranojnë shërbime të ujërave të zeza nuk duhet të ngarkohen për shërbimet në fjalë.

Deklarata e Politikës së Ujit dhe Ujërave të Zeza Nr. 16: “Përputhja me standardet e mjedisit”

"Nuk është praktikë të kërkohej nga ofruesit e shërbimeve të jenë në përputhje të plotë me standardet të BE dhe Kosovës mbi mbrojtjen e mjedisit. Qasja në faza në arritjen e përputhshmërisë me standardet është konsideruar më e përshtatshme. Koha për përputhjen me standardet dhe çfarëdo standarde të përkohshme nuk përcaktohet nga ZRRUK por është përgjegjësi e qeverisë".

Përputhja me obligimet e mjedisit të bëhet në pajtueshmëri me afatin kohor të përcaktuar nga qeveria gjatë së cilës kohë kompanitë mund të ndërmarrin investime të nevojshme dhe kostot të përfshihen në tarifa në mënyrë graduale gjatë investimeve të tilla.

Deklarata e Politikës së Ujit dhe Ujërave të Zeza Nr. 17: “Parimi Ndotësi Pagan”

*"Politika tarifore mbështet **konceptin ndotësi pagan** dhe ofron tarifa më të larta për konsumatorët jo-shtëpiak që konsiderohet se gjenerojnë efluentë që janë më ndotës se ujërat e zeza të amvisërive, p.sh. nivele më të larta të derdhjeve të materieve të ngurta dhe nevojës biokimike për oksigjen (NBO). Në bazë të asaj që konsumatorët jo-shtëpiak kanë më shumë gjasa për të gjeneruar efluent ndotës, ka një arsye për të ngarkuar ata me një tarifë më të lartë se konsumatorët shtëpiak".*

Bazuar në arsyetimin se efluentët nga konsumatorët jo-shtëpiak në përgjithësi janë më ndotës sesa ujërat e zeza të konsumatorëve shtëpiak, tarifat për ujërat e zeza për konsumatorët jo-shtëpiak do të caktohen në një nivel më të lartë se sa për konsumatorët shtëpiak. Në plan afat-gjatë tarifat e ujërave të zeza për konsumatorët jo-shtëpiak mund të përcaktohen në bazë të formulës Mogden.

2.2.5 Fletët për Dialogun e Politikave

Fletët për Dialogun e Politikave për disa çështje kyçe të politikave të ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë janë përgatitur nga Konsulentët e SECO në Shtator të vitit 2014 me kërkesën e ZBZ/SECO dhe mbulojnë dhjetë çështje të politikave që përfshijnë tarifat uniforme rajonale të ujit, tarifat e shkarkimit të ujërave të zeza, dhe eficiencën e arkëtimit. Fleta e dialogut për tarifat uniforme rajonale të ujit mbështet kornizën e përgjithshme të politikës për tarifat uniforme të ujit dhe ujërat e zeza në Kosovë ashtu siç janë të përcaktuara në Politikën Tarifore aktuale të ZRRUK. Politika e tarifave uniforme rajonale të ujit vë në dukje se "zbatimi dhe fuqizimi i tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza është i rëndësishëm për të promovuar Parimin Ndotësi Pagan **dhe për të rritur pranimin e tarifave uniforme rajonale për ujërat e zeza**". Fleta për dialogun e politikës për tarifat uniforme rajonale të ujit është e përfshirë në **Shtojcën B** ndërsa për tarifat e shkarkimit në **Shtojcën C**.

2.3 Legjislacioni përkatës për Ujë dhe Ujëra të Zeza në Kosovë

2.3.1 Legjislacioni Primar

Pjesët kryesore të legjislacionit primar në Kosovë lidhur me menaxhimin mjedisor të ujit dhe ujërave të zeza dhe rregullimin ekonomik të KRU duke përfshirë vendosjen e tarifave të ujit dhe ujërave të zeza, janë të përmbledhura më poshtë:

Ligji i Ujit

Ligji Nr 04/L-147 "Për Ujin" është pjesa kryesore e legjislacionit primar në Kosovë për sektorin e menaxhimit të ujit dhe ujërave të zeza.

Sipas Nenit 6.1.1 Parimi ndotësi paguan përcaktohet si *"çdo person që shkakton apo lejon shkarkime të ndotjes, do të përgjigjet financiarisht dhe penalisht, për të gjitha shpenzimet që dalin, përfshirë edhe shpenzimet për parandalimin e ndotjes, masat e nevojshme kontrolluese, shpenzimet administrative, shpenzimet riparuese apo kompensuese, në pajtim me këtë ligj."*

Ligji i ZRRUK

Ligji Nr. 03/L-086 është legjislacioni primar në Kosovë që mbulon licensimin dhe rregullimin ekonomik të shtatë kompanive rajonale për furnizim me ujë dhe ofrimin e shërbimeve të ujërave të zeza nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK). ZRRUK i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe është përgjegjëse sipas legjislacionit të tanishëm, mes tjerash, për *"përcaktimin dhe aprovimin e tarifave të shërbimit për shërbimet e rregulluara, duke u siguruar që tarifat janë të drejta dhe të arsyeshme dhe mundësojnë qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve"*, dhe poashtu për monitorimin e standardeve të shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Ligji aktual i ZRRUK është në fazat përfundimtare të rishikimit por rishikimet e pritura nuk kanë gjasa të ndryshojnë përgjegjësitë e ZRRUK në lidhje me rolin e vet primar të licensimit apo përcaktimit/aprovimit të tarifave të ujit dhe ujërave të zeza për shtatë kompanitë rajonale të ujit dhe ujërave të zeza.

Autorizimet dhe përgjegjësitë e ZRRUK janë dhënë në uebfaqen e ZRRUK dhe janë të përsëritura më poshtë:

- *Licenson ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë: (i) shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të zeza, (ii) furnizimin e ujit me shumicë për ndërmarrjet e ujësjellësit; (iii) shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta, dhe (iv) shërbimet e deponimit të mbeturinave të ngurta (të gjitha së bashku "Ofruesit e Shërbimeve");*
- *Përcakton dhe aprovon tarifat e shërbimit për shërbimet e rregulluara, **duke u siguruar që tarifat janë të drejta dhe të arsyeshme** dhe mundëson qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve;*
- *Mbron konsumatorët duke zbatuar pajtueshmërinë me standardet e shërbimit për ofruesit e licensuar të shërbimeve;*
- *Mbikëqyr dhe zbaton Kartën e Konsumatorëve e cila përmbanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për të dy, ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorin;*
- *Mbikëqyr dhe zbaton regjimin e shkyçjeve dhe kyçjeve ilegale*

- *Krijon dhe përkrah Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve në secilën zonë të shërbimit- shtatë regjionet e Kosovës.*

2.3.2 Legjislacioni Sekondar

Pjesët kryesore të legjislacionit sekondar lidhur me menaxhimin e ujërave dhe ujërave të zeza të cilat përfshijnë tarifat e shkyçjes dhe cilësinë e efluentit, janë të përmbledhura më poshtë:

Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2006 mbi Tarifat e Shkyçjes

Udhëzimi Administrativ i Qeverisë Nr. 06/2006, (promovuar nga MMPH) rregullon çështjet e shfrytëzimit të ujërave dhe shkarkimit të ujërave të zeza si dhe kushtet për pagesën e tarifave përkatëse. MMPH ka shqyrtuar këtë udhëzues administrativ dhe procedura aprovuese është pezulluar për shkak të procesit të riorganizimit të Qeverisë, pas zgjedhjeve të përgjithshme të fundit.

Tarifat e shfrytëzimit të ujit prej 0.001 EUR/m³ zbatohen pjesërisht për KRU dhe konsumatorët e mëdhenjë të ujit (p.sh. prodhuesit e ujit mineral).

Tarifat e shkarkimit të ujërave të zeza (0.001 EUR/m³) nuk aplikohen në praktikë nga MMPH. Shihni **Shtojcën C**.

Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2008 për Standardet e efluentit

Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2008 përcakton kushtet, metodat, parametrat dhe standardet e efluentit për shkarkimin e ujërave të zeza, mjedisin (për ITUZ > 2'000 popullësi ekuivalente) dhe kushtet dhe standardet për shkarkimin e ujërave të ndotura industriale në rrjetin e kanalizimeve publike.

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) aktualisht është duke zbatuar standardet e trajtimit të ujërave të zeza për industrinë e mëdha (miniera, çimento, prodhimi i energjisë) dhe është duke bërë presion mbi industrinë dhe hotelet tjera për të implementuar sistemet e përshtatshme të trajtimit.

ITUZ në Skënderaj është impianti i parë që është konstruktuar dhe mandatuar në Kosovë për trajtimin e ujërave të zeza shtëpiake. ITUZ raporton për performancën duke përfshirë cilësinë e efluentit të trajtuar, njëherë në muaj tek MMPH.

3 TARIFA UNIFORME/ LOKALE DHE PARIMI NDOTËSI PAGUAN

3.1 Perspektiva Globale

3.1.1 Tarifa Uniforme Kundrejt asaj Lokale

Në nivel global, aplikimi i ngarkesave/ tarifave⁵ *uniforme është* një normë që përdoret gati nga të gjithë ofruesit/ ndërmarrjet e shërbimit të sektorit publik apo atij privat të rregulluar. Një qasje *uniforme* për të ngarkuar për shërbimet e ndërmarrjes zbatohet pothuajse universalisht, pavarësisht nëse ofruesi i shërbimit operon si monopol (p.sh. shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza, shërbimet e energjisë elektrike apo shërbimet postare) apo operon në konkurrencë me ofrues tjerë të ngjajshëm (p.sh. telekomët) por është subjekt i ndonjë forme të rregullimit ekonomik. Aty ku mbulimi i shërbimit është shtetëror (p.sh. telekomët, apo shërbimet e energjisë elektrike) konsumatorët në gjithë vendin nuk e vërejnë se ngarkesat e vëna nga ofruesi i shërbimeve **për të njëjtin nivel “mesatar” të shërbimit⁶** varen direkt nga sasia e përdorimit të shërbimit- dhe jo nga faktorë të tjerë veçanërisht nga vendodhja në zonën e shërbimit ku konsumatori jeton. Kur shërbimi është rajonal, konsumatorët brenda secilit rajon do të duhej poashtu që të mos vërenin se principet e njëjta të përmendura më lartë të aplikohen edhe brenda rajonit sikurse te rasti i shërbimeve në nivel shtetëror. Përfundimisht, baza për ngarkesat që përcaktohen nga ofruesit e shërbimeve për të njëjtin nivel “mesatar” të shërbimeve nuk duhet të ndryshoj dhe veçanërisht nuk duhet të varet nga faktorë tjerë variabil siç është vendi ku jeton konsumatori (p.sh. urban apo rural).

Mënyrat tjera të mundshme të përcaktimit të ngarkesave/tarifave, edhe pse sipërfaqësisht atraktive p.sh. tarifat *lokale* për shërbim, të cilat kërkojnë të marrin parasysh koston aktuale të njësisë së ofrimit të nivelit të njëjtë “mesatar”, janë sipas definicionit **diskriminuese**, dhe poashtu **shumë të kushtueshme/jopraktike për tu administruar** dhe, nëse do miratoheshin, do rezultonin në **rritje të papranueshme çdo herë që kostot lokale rriten⁷**- të gjitha për pak përfitim për konsumatorin apo për ofruesin e shërbimit.

Përfitimet tjera të ngarkimit uniform për shërbimet krahasuar me ngarkimin lokal përfshijnë atë se ngarkesat administrative dhe rregullatore mbahen sa më të ulta që është e mundur gjatë periudhës së përcaktimit të tarifave dhe në këtë mënyrë arrihet stabiliteti i të ardhurave.

3.1.2 Parimi Ndotësi Pague

Parimi Ndotësi Pague (PNP) është një parim thelbësor që mbështet menaxhimin dhe përgjegjshmërinë mjedisore në të gjitha vendet e OECD dhe Komunitetit Evropian. Më poshtë paraqitet një përkufizim i përshtatshëm:

Përkufizimi⁸

⁵Ngarkesat dhe tarifat përdoren shpesh si dy fjalë në këtë raport por kanë kuptimin e njëjtë.

⁶“Mesatar ” nënkupton përafërsisht apo në zhargonin e përditshëm paushall. Është e qartë se nivelet e shërbimit ndryshojnë në një masë të kufizuar në të gjithë zonën e shërbimit të kompanisë për shkak të një sërë faktorësh.

⁷ P.sh. duke zgjeruar apo rehabilituar rrjetin e kanalizimit lokal apo duke zgjeruar kapacitetin e ITUZ.

⁸ Përkufizim i marrë nga Wikipedia.

Në ligjshmërinë e mjedisit, *parimi ndotësi paguan* është nxjerrë me qëllimin që pala përgjegjëse për ndotje të jetë poashtu përgjegjëse për të paguar dëmin e bërë mjedisit natyror.

Andaj, në terma të thjeshtë, sa më i madh ndikimi i ndotjes së mjedisit, aq më shumë kërkohet nga ndotësi të paguaj ngarkesat e ndotjes. Zbatimi i këtij parimi tek shkarkimet e ujërave të zeza nënkupton se ndotësi (p.sh. konsumatori) ose duhet të paguaj për shërbimet e ujërave të zeza të ofruara nga KRU duke përfshirë kostot e grumbullimit, trajtimit dhe shkarkimit, përmes një tarife të drejtë të sasisë së ujërave të zeza të gjeneruara ose, nëse ujërat e zeza grumbullohen por nuk ka asnjë komponent për trajtimin e ujërave të zeza, konsumatori duhet në teori të kërkohet që të paguajë një ngarkesë të ndotjes duke u bazuar në konsum, për të kompensuar dëmin e shkaktuar mjedisit nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara.

Në vendet shumë të zhvilluara Evropiane, p.sh. Gjermania, Zvicra, Britania e Madhe, efluenti i trajtuar nga impiantet operationale të trajtimit të ujërave të zeza pritët të jetë plotësisht në pajtim me standardet e BE për efluent, dhe pothuajse të gjitha komunitetet më të mëdha se 2,000 b.e. (banorë ekuivalent) janë të lidhur me ITUZ. Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës pritët të paguajnë të paktën kostot operationale të ITUZ si pjesë të tarifës së tyre të ujit dhe ujërave të zeza. Tarifa e ujit dhe ujërave të zeza bazohet normalisht mbi një pagesë fikse dhe një pagesë variable lidhur direkt me volumin e ujit të konsumuar dhe volumin e ujërave të zeza të shkarkuara në kanalizimin "publik". Ofruesi i shërbimit për ujë dhe ujëra të zeza duhet të i përmbushë standardet e përshtatshme të efluentit për ujërat e zeza të trajtuara dhe mos-përputhshmëria me këto standarde pa ndonjë arsye të fortë zakonisht rezulton në një gjobë të rëndë nga rregullatori mjedisor, duke u bazuar në nivelin aktual apo të vlerësuar të ndotjes, të gjitha këto plotësisht në përputhje me Parimin Ndotësi Pagan. Konsumatorët shtëpiak që nuk janë të lidhur në sistemin e kanalizimit publik pritët që të trajtojnë ujërat e zeza të tyre me p.sh. gropat septike lokale dhe ata ngarkohen me një tarifë shkarkimi në përputhje me parimin "ndotësi pagan" nëse ujërat e zeza të tyre shkarkohen të patrajtuara apo pjesërisht të trajtuara në trupat ujore lokale.

3.2 Perspektiva Rajonale

3.2.1 Tarifat Uniforme kundrejt atyre lokale

Vendet Rajonale (Ballkanike)

Një shqyrtim i shkurtër i politikave dhe metodologjive tarifore të ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë është paraqitur në **Kapitullin 2** të këtij raporti, ndërsa për tre vendet përfaqësuese Ballkanike (Maqedonia, Bosnje-Hercegovina dhe Shqipëria) është paraqitur në **Kapitullin 5**. Politikat tarifore, udhëzimet apo rregullat për Shqipëri dhe për Bosnje-Hercegovinë nuk i referohen në mënyrë eksplicite një politike *uniforme* të tarifave. Megjithatë, përvetësimi i politikës së tarifës uniforme është i nënkuptuar gjatë ofrimit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza për konsumatorët në Shqipëri dhe kjo qasje është konfirmuar në diskutimet e fundit me Entin Rregullator të Ujit për Shqipëri (ERRU) në datën 21 Prill 2015 në Tiranë.

Kosovë

Politika e Ujërave të Kosovës⁹ dhe Politika Tarifore aktuale e ZRRUK¹⁰ qartazi përkrahin një tarifë uniforme të ujërave të zeza të aplikueshme në të gjitha zonat e shërbimit të KRU për të gjithë konsumatorët që shërbehen nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet). Politika Tarifore e ZRRUK poashtu thekson që konsumatorët pa qasje në sistemin e ujërave të zeza nuk duhet të ngarkohen për shërbimet e ujërave të zeza.

Politika e Ujërave të Kosovës poashtu rekomandon që ZRRUK të hulumtojë mundësinë e aplikimit të një tarife uniforme të ujërave të zeza në një nivel të gjërë pellgu¹¹. Shihni më poshtë, **Figurën 1**, e cila tregon burimet kryesore të lumenjëve për zonën ujëmbledhëse të Drinit.




Figura 1: Pellgu Lumor Drini

Pasi secili prej ITUZ të rinjë që shërbejnë qytetet më të mëdha të Kosovës do të mandatohen në disa vite të ardhshme, të gjithë konsumatorët shtëpiak të lidhur në sistemin e kanalizimit të KRU në secilën zonë shërbimi të KRU do **vazhdojnë të pranojnë nivelin e njëjtë (mesatar) të shërbimeve të ujërave të zeza, pavarësisht nëse kanalizimet e KRU që shërbejnë konsumatorët janë të lidhur me ITUZ e ri apo jo**. Këta konsumatorë nuk kanë arsye për të kundërshtuar nëse ngarkohen me tarifën e ujit dhe të ujërave të zeza, e cila përfshinë një komponent për të mbuluar shpenzimet e trajtimit të ujërave të zeza duke u bazuar në një tarifë "uniforme" të ujërave të zeza në të

⁹ Dokumenti final, 2015 është siguruar nga sekretariati i KNMU gjatë përgatitjes së këtij raporti. Politika e Ujërave është aprovuar nga QeK.

¹⁰ Gjindet në uebfaqen e ZRRUK: wwro-ks.org

¹¹ Kapitulli 4 rishikon anët positive dhe negative të tarifave uniforme të aplikuara në nivelin e pellgjeve lumore.

gjithë zonën e shërbimit dhe duke u zbatuar në baza volumetrike për të gjithë ata konsumatorë të lidhur në sistemin e kanalizimit të KRU.

Ngarkimi me pagesë përmes qasjes së tarifave lokale, për vetëm ata konsumatorë të lidhur në ITUZ përmes sistemit të kanalizimit do ishte vërtetë **diskriminuese**, dhe do të çonte në tarifa shumë të larta për konsumatorët në zonën ku ndikon përballueshmëria e tarifave tek konsumatorët shumë të varfër dhe kjo do rezultonte në ndryshime/ rritje të papranueshme sa herë që do mandatohej një ITUZ i ri, ose do të zgjerohej ndonjë ITUZ ekzistues apo infrastruktura e kanalizimit që i shërbejnë një zone lokale.

Për më tepër, adoptimi i një tarife lokale për ujërat e zeza përmes modifikimit të politikës tarifore aktuale të ZRRUK mund të rris numrin e konsumatorëve të frustruar (p.sh. ata konsumatorë të KRU të lidhur me një ITUZ të ri dhe të ngarkuar me një tarifë lokale të ujërave të zeza e cila ka qenë shumë më e lartë sesa tarifa uniforme ekuivalente), të cilët refuzojnë të paguajnë për shërbimet e ofruara nga KRU dhe/ose **ndërmarrin procedura ligjore ndaj KRU dhe/ ose ZRRUK për tarifën e ujërave të zeza të cilët janë diskriminuese.**

Shënim: Të gjithë konsumatorët e lidhur në infrastrukturën e kanalizimit të KRU pranojnë nivelin e njëjtë mesatar të shërbimit **pavarësisht nëse ujërat e zeza të tyre janë trajtuar apo jo.** Ata konsumatorë që nuk janë të lidhur në infrastrukturën e KRU nuk pranojnë "shërbime të ujërave të zeza" dhe prandaj nuk ngarkohen me tarifën uniforme (të ujërave të zeza) sipas Politikës Tarifore të ZRRUK Nr. 4 por duhet të paguajnë një tarifë shkarkimi për shkarkimin e ujërave të zeza të patrajuara në trupat lokale ujore. MMPH aktualisht nuk e aplikon tarifën simbolike të shkarkimit për këta konsumatorë.

3.2.2 Ndikimi Mjedisor dhe Nivelet e Shërbimeve të Konsumatorit

Gjatë përgatitjes së këtij raporti disa palë të interes kanë treguar se konsumatorët në Kosovë të cilët shërbehen nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) e KRU të cilët **janë** të lidhur me impiantin e trajtimit të ujërave të zeza pranojnë një nivel më të lartë të shërbimit sesa konsumatorët e shërbyer nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) të cilët nuk janë të lidhur me impiantin e trajtimit të ujërave të zeza dhe për këtë arsye nuk duhet të argumentohet që të dy kategoritë janë duke marrë nivelin e njëjtë të shërbimeve dhe për këtë arsye duhet të ngarkohen me të njëjtën tarifë uniforme.

Kjo pikëpamje mund të refuzohet përmes argumenteve kryesore të mëposhtme:

- Globalisht, shumica e konsumatorëve të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza me të drejtë nuk shqetësohen se çfarë ndodhë me kanalizimin e tyre shtëpiak sapo të shkarkohet në mënyrë të sigurt në kanalizimin publik. Nivelin e trajtimit dhe ndikimin që në mjedis ka shkarkimi i ujërave të zeza të patrajuara apo pjesërisht të trajtuara, konsumatorët zakonisht e konsiderojnë si një çështje të rregullatorit mjedisor dhe **jo** një çështje të shërbimit të konsumatorëve. Shqetësimi kryesor i konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujërave të zeza është që në përgjithësi gjatë stuhive, ujërat e zeza të papërpunuara të mos përbyten në shtëpitë e tyre d.m.th. që vetë kanalizimet të jenë të dizajnuara dhe të mirëmbajtur në mënyrë adekuate që të mos mbingarkohen. Rrjedhimisht, treguesit e niveleve të shërbimeve të konsumatorëve (të cilët pasqyrojnë përvojën/ perceptimin e konsumatorëve për shërbimin e pranuar nga ofruesi i shërbimit), normalisht përfshijnë numrin e shtëpive të përbytura nga ujërat e

zeza në vlerësimin e performancës së kompanisë së ujësjellësit, por nuk iu referohen ndikimeve tjera mjedisore p.sh. incidentet e ndotjes, pajtimi për lejen e shkarkimit, të cilat janë çështje për të u rregulluar nga ana e rregullatorit mjedisor.

- Praktika e mirë e rregullatorit ndërkombëtar e.g. OFWAT¹² në Angli dhe Wales pohon se performanca vjetore e përgjithshme e kompanisë rajonale vlerësohet aktualisht nga OFWAT duke iu referuar katër kategorive të mëposhtme apo katër treguesve kyç të performancës:
 - a. Përvoja e konsumatorit
 - b. Ndikimi mjedisor
 - c. Besueshmëria dhe disponueshmëria
 - d. Financat

Performanca mjedisore përfshin treguesit vijues: emetimet e gazit, incidentet e ndotjes, dhe lejimi i shkarkimit, ndërsa treguesit e performancës së përvojës së konsumatorëve lidhur me shërbimet e ujërave të zeza janë të kufizuar me numrin e pronave që gjinden në rrezik nga përmbytjet e kanalizimeve të mbingarkuara.

3.2.3 Parimi Ndotësi Pagan

Vendet Rajonale (Ballkanike)

PNP është një koncept thelbësor mjedisor që paraqitet në dokumente të ndryshme të politikave rajonale i cili mbështet aktivitetet mjedisore që përfshijnë trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza. Megjithatë, zbatimi dhe ekzekutimi i PNP ndodhet në një fazë të hershme në të gjitha vendet rajonale- kryesisht si rezultat i institucioneve mjedisore të dobta, niveleve të ulëta të të ardhurave dhe vetëdijësimit të ulët të qytetarëve për mjedisin- veçanërisht familjet me të ardhura të ulëta dhe qytetarët e moshuar të cilët janë më pak të njohur me çështjet mjedisore rajonale dhe globale.

Kosova

Në Kosovë, sipas Udhëzimit Administrativ Nr 06/2006, aktualisht aplikohet një tarifë/gjobë shumë e ulët¹³ prej €0.001/ m³ për shkarkimin e ujërave të zeza të patrajtuara në një trup uhor. Megjithatë, kjo tarifë/gjobë simbolike minimale nuk aplikohet nga MMPH tek konsumatorët shtëpiak individual pa qasje në kanalizim dhe as tek KRU- që shkarkojnë ujërat e zeza të patrajtuara nga një numër i konsumatorëve që janë të lidhur në rrjetin e kanalizimit të KRU.

Shënim: Kostoja administrative e MMPH për arkëtimin e tarifës nga numri shumë i madh i konsumatorëve/ndotësve shtëpiak do të tejkalonte të ardhurat e marra duke u bazuar në shumën aktuale mesatare të tarifës edhe nëse do ishte e mundshme të mblidhen të gjitha apo shumica e tarifave/gjobave. Andaj përcaktimi i një tarife simbolike për ndotësit shtëpiak, nëse nuk imponohet për zbatim nga MMPH më së miri mund të konsiderohet si simbolikë apo aspiratë. Për më tej, konsiderohet se shumë prej konsumatorëve shtëpiak të ngarkuar me një tarifë shkarkimi në parim do rezistonin të paganin, duke përmendur pamundësinë e secilit konsumator për të trajtuar ujërat e zeza të tyre individualisht.

¹² Shih www.ofwat.gov.uk/regulating/casework/reporting/rpt_los2013-2014performance

¹³ Aktualisht tarifa e shkarkimit është nën shqyrtim nga MMPH dhe ngarkimi për njësi mund të zvogëlohet më tej (!).

Është një rast më i mirë për MMPH të fillojë të ngarkojë KRU për shkarkimin e ujërave të zeza të patrajtuara nga kanalizimet tek trupat uJOR edhe nëse ato ngarkesa do ishin modeste në aspektin financiar dhe shumë simbolike edhe nëse KRU nuk gjinden në një pozitë për të investuar në një ITUZ të ri. Kjo do ofronte një nxitje financiare për QK dhe për KRU të kërkojnë financim për të zgjeruar kapacitetin e ITUZ apo për të ndërtuar ITUZ të reja në mënyrë që, sa më shpejtë që është e mundur, ujërat e zeza të jenë të trajtuara për të gjithë ata konsumatorë të lidhur në infrastrukturën e kanalizimit, dhe në këtë mënyrë nuk do ishte më e aplikueshme pagesa për shkarkim.

Nëse një tarifë/gjobë e tillë do vendosej në çdo konsumator shtëpiak individual, shuma tipike për konsumator shtëpiak në muaj, duke supozuar që mesatarisht janë 5 persona në një familje dhe 100 litra ujë të konsumuar për kokë banori në ditë, do ishte 1.5 cent në muaj apo përafërsisht **2€ në vit për një familje mesatare**. Kjo është qartazi një shumë minimale, thjeshtë një tarifë/gjobë simbolike dhe e pabazuar në ndonjë supozim koherent për dëmin aktual në mjedis nga shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara. Megjithatë, kjo përfaqëson një nivel shumë të ulët të vetëdijës së publikut dhe qeverisë për ndikimet që ka në mjedis ndotja e ujërave të zeza dhe poashtu nivelet e ulëta të të ardhurave të konsumatorëve shtëpiak dhe nivelet e ulëta të gatishmërisë të shumë konsumatorëve shtëpiak në Kosovë për të paguar për masat e përmirësimit të mjedisit.

Në mungesë të një tarife shkarkimi më realiste dhe më të besueshme që ngarkohet dhe në mënyrë rutine mbulohet nga MMPH në konsumator individual apo në KRU për shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara, ngarkimi i të gjithë konsumatorëve të KRU të lidhur në rrjetin e kanalizimit me një tarifë uniforme të ujërave të zeza (nëse kanalizimet e KRU janë të lidhur me një ITUZ ose shkarkohen direkt në një trup uJOR) nuk është diskriminuese dhe në terma të thjeshtë është në përputhje me Parimin Ndotësi Paguej ¹⁴. Me të vërtetë ngarkimi me një tarifë/gjobë shumë të vogël simbolike i konsumatorëve shtëpiak të cilët janë të lidhur në një kanalizim të KRU kur ato ujëra të zeza **nuk** trajtohen në një ITUZ dhe shkarkohen të patrajtuara, ndërsa në të njëjtën kohë ngarkimi i atyre konsumatorëve shtëpiak të lidhur me një ITUZ përmes rrjetit të kanalizimit të KRU me një tarifë lokale për ujëra të zeza më të lartë dhe më realiste **për saktësisht nivelin e njëjtë të shërbimit të ujërave të zeza**, do ishte **jo-logjike dhe diskriminuese**, dhe poashtu do kishte implikime të përballueshmërisë për pagesë për konsumatorët shumë të varfër.

Kufizimet e PNP për konsumatorët pa qasje

Për ata konsumatorë shtëpiak që nuk janë të lidhur në rrjetin lokal të kanalizimit të KRU, e që është tipike në shumë qytete dhe fshatra më të vogla në Kosovë, është pothuajse e pashmangshme që ata do të vazhdojnë të shkarkojnë ujërat e zeza të patrajtuara tek trupi uJOR më i afërt edhe për një kohë dhe nuk do ngarkohen me asnjë tarifë shkarkimi nga MMPH për arsyet e marra në konsideratë më lartë e që bie në kundërshtim me PNP. Kjo situatë do vazhdojë të jetë në Kosovë derisa shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza për këto komunitete të vogla përfundimisht të integrohen në zonat e shërbimit të KRU në pajtim me politikën e QK me ç'rast do aplikohet politika e tarifave uniforme e ujërave të zeza dhe shpresohet që përfundimisht ITUZ ose do zgjerohen ose do të

¹⁴ Në teori, konsumatorët e lidhur kanalizimi i të cilëve shkarkohet i patrajtuar në mjedis përmes kanalizimeve të KUR (ose KRU që operon dhe mirëmban rrjetin e kanalizimit) duhet të ngarkohen me një tarifë të ndotjes e cila është pak më e lartë sesa tarifa e ngarkuar për ata konsumatorë kanalizimi i të cilëve trajtohet tek një ITUZ. Mirëpo, argumenti bie poshtë kur vihen ngarkesat e ndotjes. Rasti më bindës për të ngarkuar njëjtë të gjithë konsumatorët e lidhur është se a) shërbimi i ujërave të zeza i pranuar nga dy llojet e konsumatorëve është saktësisht i njëjtë dhe b) e bën tarifën e përgjithshme më të përballueshme. Çdo marrëveshje tjetër tarifore dmth tarifat lokale janë **diskriminuese** sepse disa konsumatorë do ngarkoheshin më shumë për, çka në thelb është, niveli i njëjtë i shërbimit të ujërave të zeza.

mandatohen ITUZ më të vogla rurale për të përballur kërkesën e shtuar. Për një afat të shkurtër Parimi ndotësi paguan nuk do aplikohet në këtë sektor të popullatës për arsye praktike, dhe kjo padyshim do e bëjë më të vështirë të aplikohet tarifa uniforme për të gjithë ata konsumatorë të cilët janë të lidhur me një rrjet kanalizimi lokal të KRU. Mirëpo, ata konsumatorë që nuk janë të lidhur me rrjetin lokal të KRU **nuk pranojnë ndonjë nivel të shërbimit të ujërave të zeza nga KRU** dhe kështu tarifa uniforme e ujërave të zeza duhet të vazhdojë **të mos aplikohet** tek këta konsumatorë, siç ndodhë aktualisht.

Ofrimi i shërbimeve të ujërave të zeza për Komunitetet Rurale

Çështja kryesore se si të prezantohet infrastruktura e kanalizimit dhe trajtimi efektiv i ujërave të zeza lokale - operimi dhe mirëmbajtja të kryera nga KRU për komunitete më të vogla (e.g. kallamishte: anglisht “reed beds”), konsiderohet jashtë fushëveprimit të këtij shqyrtimi. Megjithatë, prioriteti kryesor në Kosovë është të adresohet ndotja e ujërave të zeza urbane nga qytetet më të mëdha ku ndikimi në mjedis është qartazi më i rëndë sesa nga komunitetet më të vogla të shpërndara, zakonisht rurale.

Disa prej pjesëmarrësve nga takimi i tryezës së rrumbullakët kanë ngritur shqetësimet e tyre në lidhje me kundërshtimet e mundshme dhe mungesën e vullnetit për të paguar tarifën uniforme për shërbimet e ujërave të zeza nga ana e konsumatorëve shtëpiak të cilët janë lidhur në sistemin e KRU gjatë kohës së fundit dhe të cilët vijnë nga fshatrat rurale. U theksua se Deklarata 5 e Politikës Tarifore e ZRRUK lejon një rritje graduale të tarifave gjatë periudhës tre-vjeçare. Është poashtu veçanërisht e rëndësishme që të gjithë konsumatorët e rinj të KRU janë të vetëdijshëm për përfitimet e përgjithshme të trajtimit të ujërave të zeza në mjedis dhe aplikimin e Parimit Ndotësi Paguan.

4 TARIFAT UNIFORME PËR PELLGJET LUMORE

4.1 Hyrje

Përderisa e mbështet plotësisht qasjen e tarifave uniforme në të gjithë zonën e shërbimit të Ofruesve të shërbimeve, Politika e Ujërave të Kosovës përfshinë edhe kërkesën që Enti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ZRRUK) "të vlerësojë mundësinë e aplikimit të tarifave uniforme për ujërat e zeza në nivel të pellgjeve lumore".

4.2 Konsolidimi

Konsolidimi i shtatë KRU ekzistuese në 3 ose 4 Kompani të mëdha të konsoliduara duhet të sigurojë rritjen e ekonomisë së shkallës e cila do të rezultonte me tarifa pak më të ulëta për një zonë shërbimi më të zgjeruar me kusht që është përmbushur efikasiteti e prituri. Ky avantazh i prituri megjithatë është rrjedhojë e procesit të konsolidimit-dhe jo rrjedhojë e asaj se a është adoptuar qasja sipas pellgjeve lumore.

4.3 PNP

Një avantazh i mundshëm i aplikimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza (dhe tarifave uniforme) në baza të pellgjeve lumore është se nga perspektiva e PNP ekziston një lidhje e qartë në mes të a.) konsumatorëve që pritët të paguajnë tarifa më të larta për shërbime të përmirësuara të trajtimit të ujërave të zeza (pavarësisht nga fakti nëse kanalizimi i tyre është i lidhur me ITUZ në afat të shkurtër apo jo) dhe b.) përfitimet e konsumatorëve nga zvogëlimi i ndotjes së lumenjve dhe burimeve ujore nëntokësore dhe për këtë arsye përmirësimin e kushteve mjedisore në lumenjtë brenda çdo pellgu lumor si një mjet publik.

Prandaj mandati i Autoriteteve të Pellgjeve Lumore¹⁵ duhet të ketë si prioritet shpërndarjen e informacioneve tek qytetarët në lidhje me përfitimet e trajtimit të ujërave të zeza për shëndetin publik dhe mjedisin dhe këto Autoritete duhet të jenë aktive në promovimin e iniciativave të ndërgjegjësimit publik bazuar në PNP.

4.4 Tarifat Uniforme për Pellgjet Lumore

Janë dy skenarë bazikë që do të duhej të konsideroheshin si në vijim:

- Në të parën, zonat e shërbimit të KRU nuk korrespondojnë me kufijtë e pellgjeve lumore (siç është gjendja aktuale). Aplikimi i tarifave uniforme të ujërave të zeza për pellgjet lumore, atëherë, do të kërkonte marrëveshje për tarifa uniforme në mes të KRU si dhe transferimin e financave në mes të këtyre KRU. Kjo duket shumë e vështirë për të u zbatuar dhe përpjekjet e përfshira në asnjë mënyrë nuk do të mund të arsyetoheshin për të arritur avantazhin e vogël të lidhur me PNP të përmendur më lart.

¹⁵Sipas Ligjit të ZRRUK përcaktimi i tarifave është një çështje mes ZRRUK dhe KRU. Kjo përgjegjësi supozohet se do të vazhdojë edhe në të ardhmen e parashikueshme dhe Autoritetet e Pellgjeve Lumore, pas krijimit, nuk pritet të kenë ndonjë përgjegjësi në lidhje me përcaktimin e tarifave.

- Skenari i dytë është kur zonat e shërbimit të KRU korrespondojnë me kufijtë e pellgjeve lumore dhe në këtë mënyrë janë në përputhje me skenarin e konsolidimit që kanë si kriter kufijtë e pellgjeve lumore. Tarifat uniforme për pellgjet lumore, atëherë, do të rrjedhojnë automatikisht nga konsolidimi, me shumë përparësi. Mirëpo avantazhet vijnë nga tarifat uniforme në zonën e shërbimit, e jo domosdoshmërisht nga të qenit uniforme për pellgun lumor.

4.5 Konkluzione

Konsolidimi i KRU në Kompani shtrirja e shërbimeve e të cilave përkon me kufijtë e pellgjeve lumore duhet automatikisht të të çojë në tarifa uniforme që do të duhej të aplikoheshin në secilin prej pellgjeve lumore, me të gjitha avantazhet e tarifave uniforme në të gjithë zonën e zgjeruar të shërbimeve. Megjithatë, nëse imponohen tarifat uniforme për zonat e shërbimeve të disa KRU (pa u përcjellur me konsolidim) do të jetë shumë e vështirë dhe nuk do të përcjellet me ndonjë avantazh të vërtetë dhe do të kishte disa disavantazhe.

5 SHQYRTIMI DHE ANALIZA E STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT TË ITUZ LIDHUR ME PËRBALLUESHMËRINË E TARIFAVE

5.1 Hyrje

Ky sesion shtjellon dhe prezanton gjetjet për komponentet vijuese të TeR:

- Shqyrtimi i studimeve të fizibilitetit përkatëse për trajtimin e ujërave të zeza dhe ndërmarrja e krahasimit analitik dhe ndikimit të **përcaktimit të tarifës lokale kundrejt asaj uniforme;**
- Paraqitja e **përfitimeve dhe anëve negative të tarifës ekzistuese uniforme** duke përfshirë një **analizë të përballueshmërisë dhe gatishmërisë për të paguar** që rezulton nga aplikimi i përcaktimit të tarifës uniforme për ujëra të zeza në gjithë zonën e shërbimit të KRU.

Për këtë qëllim janë shqyrtuar të shtatë Studimet e Fizibilitetit për ITUZ në Kosovë, të cilat përbëjnë Studimet e Fizibilitetit për ITUZ në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj. Derisa pesë nga shtatë Studimet e Fizibilitetit kanë marrë në konsideratë vetëm një opsion tarifar d.m.th. qasjen e tarifës uniforme, Studimet e Fizibilitetit për ITUZ në Gjakovë dhe Pejë kanë ofruar krahasime analitike të detajuara dhe ndikimin e qasjes së tarifës lokale kundrejt asaj uniforme dhe për këtë arsye janë të elaboruara më hollësisht në nën-sesionet në vijim.

5.2 Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në 5 Kompanitë Rajonale të Ujit: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj

Pesë studimet e fundit të fizibilitetit janë shqyrtuar si pjesë kyçe e studimit aktual që përfshin ITUZ e reja dhe masat përcjellëse të kanalizimit në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj. Sipas analizave të ofruara në raporte, duke supozuar se **aplikohet qasja e tarifës uniforme e ujërave të zeza**, dhe duke lejuar **mbulimin e plotë të kostove** në tarifat e propozuara të ujit dhe grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, kostoja e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza mbetet **brenda kufijve të përballueshmërisë për konsumatorët shtëpiak me të ardhura mesatare dhe të ulëta.**

Me fjalë tjera, kostot e kombinuara të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza do mbesin nën pragun e pranuar ndërkombëtarisht në më pak se 5% të të ardhurave mesatare të konsumatorëve shtëpiak për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza, duke supozuar qasjen e tarifës unifome. Provat tregojnë se në të shumtën e rasteve, konsumatorët shtëpiak me të ardhura shumë të ulëta (varfëri të skajshme), që prezantojnë rreth 10% të konsumatorëve, në nivel kombëtar do duhej të menaxhonin konsumin e tyre në mënyrë më efikase apo të pranojnë një lloj të subvencionimit të Qeverisë për t'iu kundërvënë çfarëdo vështirësie të përballueshmërisë.

5.3 Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në Rajonin e Pejës

5.3.1 Pse zgjedhet SF i Pejës si shembull?

Studimi i Fizibilitetit (SF) i ITUZ për Pejë në vitin 2014 i financuar nga SECO është zgjedhur për të u shqyrtuar për një krahasim analitik dhe vlerësim më të detajuar të ndikimit të mundshëm të tarifave uniforme kundrejt atyre locale, sepse përfaqëson një nga Studimet e Fizibilitetit të ITUZ që janë shqyrtuar kohëve të fundit por edhe për arsye se:

- Është njëri nga Studimet e Fizibilitetit më të fundit (Shtator 2014) dhe më gjithëpërfshirësi që përfshinë supozimet e përditësuara për të ardhurat e banorëve dhe familjeve dhe përfshin marrjen në konsideratë të implikimeve për opsionet e tarifave uniforme dhe jo-uniforme në detaje - ndryshe nga pesë Studimet e Fizibilitetit të ITUZ të përshkruara në sesionin 4.2.
- Përqindja e populates me qasje në ITUZ ekzistues dhe të planifikuar/ kyçj në kanalizim për rajonin e Pejës është e ngjajshme me mesataren e ponderuar të sektorit siç tregohet në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Norma e popullatës me qasje në ITUZ ekzistues dhe të planifikuar / qasja në kanalizim për shtatë rajonet e KRU

Rajonet e KRU	p.e. me qasje në ITUZ*	p.e. me qasje në kanalizim**	norma p.e.
Prishtinë	439,000	489,159	90%
Prizren	50,000	199,011	25%
Pejë	60,000	78,200	77%
Gjakovë	32,000	85,778	37%
Mitrovicë	104,200	108,307	96%
Ferizaj	82,500	102,878	80%
Gjilan	92,400	99,146	93%
Totali/ mesatarja e sektorit	860,100	1,162,479	74%

Burimi: * Informatat janë nxjerrë nga SF për secilën ITUZ për shtatë rajone

** Për Pejë dhe Gjakovë informatat janë nxjerrë nga SF përkatëse, përderisa për 5 rajonet tjera informatat janë një llogaritje duke përdorur të njëjtat parametra si për Pejë ashtu edhe për Gjakovë, p.sh. "nr. i konsumatorëve të lidhur në kanalizim, në vitin 2013" shumëzuar me "numrin mesatar të personave për ekonomi familjare në Kosovë (5.85)".

5.3.2 Zhvillimi i tarifave

Edhe pse në Studimin e Fizibilitetit të fundit të ITUZ për Pejë në vitin 2014, i financuar nga SECO, zhvillimi i tarifave është vlerësuar duke marrë parasysh disa skenarë si nivele të ndryshme të mbulimit të kostove, tarifat rajonale uniforme dhe jo-uniforme¹⁶ në normën arkëtuese aktuale dhe të rritur, për këtë ushtrim aktual janë shqyrtuar vetëm opsionet më

¹⁶ Opsioni i tarifës jo-uniforme (apo "lokale") për ujërat e zeza ishte i përfshirë në analizën e SF të Pejës për përballeshmërinë me kërkesë të ZBZ Zyra në Prishtinë, pas konsultimeve të mëhershme në mes të Konsulentëve dhe ZRRUK.

realiste, si në vijim - kryesisht për të lejuar krahasime kuptimplota të përballueshmërisë me Studimet tjera të Fizibilitetit siç janë përmendur më sipër:

- Për mbulimin e kostos: Opsioni 3 ¹⁷- mbulim i plotë i kostove O&M dhe atyre kapitale (me 0% interes)
- Për normën e arkëtimit: Norma e tashme e arkëtimit në Pejë prej 64%.

Për vlerësimin e tarifave të ujërave të zeza, janë bërë këto supozime kryesore të mëposhtme në Studimin e Fizibilitetit të Pejës:

- ITUZ do operoj me kapacitet të plotë prej 60,000 p.e.;
- Tarifat uniforme zbatohen tek 78,200 persona aktualisht të lidhur tek një sistem i kanalizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini, ndërsa, tarifat jo-uniforme (lokale) do aplikoheshin vetëm për numrin e konsumatorëve që do lidhen në ITUZ, d.m.th. 60,000 persona;
- Nuk ka ndërsuvencionime nga konsumatorët jo-shtëpiak për konsumatorët shtëpiak, d.m.th. tarifa e njëjtë aplikohet për konsumatorët shtëpiak dhe ata jo-shtëpiak të ujërave të zeza;

Tabela e mëposhtme tregon vlerësimin e kostove vjetore specifike për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza për normën e arkëtimit prej 64% për opsionin 3.

Tabela 2. *Kostot vjetore specifike për tarifën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza për Opsionin 3: mbulim i plotë i kostove O&M dhe kostove kapitale, pa TVSH, për ITUZ në Pejë*

	Njësia	Opsioni 3
Kostot vjetore specifike ¹⁸	EUR/m3	0.50
Norma arkëtuese 64%		
Tarifa uniforme e ujërave të zeza	EUR/m3	0.60
Tarifa jo-uniforme e ujërave të zeza	EUR/m3	0.79

Burimi: SF për ITUZ në Pejë, SECO, 2014

Kostot vjetore përbëhen nga shpenzimet kapitale dhe shpenzimet operative për masat rehabilituese të rrjetit dhe ITUZ të planifikuar në Pejë deri në vitin 2021. Kostot vjetore specifike janë llogaritur duke u bazuar në konsumin total të ujit, d.m.th. gjenerimin e ujërave të zeza.

Tarifa uniforme e ujërave të zeza është llogaritur duke u bazuar në koston vjetore duke pasur parasysh numrin total të banorëve të lidhur me sistemin e kanalizimit në gjithë zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini d.m.th. 78,200 persona.

Tarifat e ardhshme të vlerësuara për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza janë dukshëm më të larta sesa tarifat aktuale të ujërave të zeza edhe për konsumatorët shtëpiak edhe ata jo-shtëpiak.

¹⁷ Vetëm Opsioni 3 merret në konsiderim në këtë sesion sepse mundëson krahasime direkte me pesë SF të ITUZ tjera të konsideruara në sesionin 4.2 ku të gjitha supozojnë se tarifën uniforme të ujërave të zeza do aplikohen dhe do mbulojnë kostot e O+M të ITUZ plus do mbulojnë plotësisht kostot kapitale (0% interes).

¹⁸ Kjo i referohet kostove të KRU për trajtimin e një metri kub të ujërave të zeza.

Konkluzioni

Mund të konkludohet se tarifa e ujërave të zeza varet fuqimisht në normën e pritur të arkëtimit, në qasjen e tarifës së adoptuar (uniforme dhe jo-uniforme) dhe në numrin e konsumatorëve të lidhur në rrjetin e kanalizimit të KRU. Për shembull, tarifa e trajtimit të ujërave të zeza mund të reduktohet nga 0.60 EUR/m³ në 0.48 EUR/m³ duke e rritur normën e arkëtimit nga 64% në 80% në rastin e tarifave uniforme.

Për më tej, aplikimi i **tarifave uniforme në vend të tarifave jo-uniforme në përgjithësi ka rezultuar në tarifa 24% më të ulëta të ujërave të zeza**. Kjo tregon rëndësinë e rritjes së normës së arkëtimit dhe aplikimit të tarifave uniforme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza.

5.3.3 Përballueshmëria

Për analizat e përballueshmërisë janë marrë në konsideratë tarifat e llogaritura të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe niveli i të ardhurave familjare për tri grupet sociale: (i) mesatare, (ii) të varfëra, dhe (iii) në varfëri të skajshme.

Analizat e përballueshmërisë janë bazuar në parimin se tavanin e përballueshmërisë për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza nuk duhet të jetë më i lartë se 5% e të ardhurave mesatare familjare. Dihet poashtu se duke u bazuar në supozime të tilla mesatare, familjet në varfëri të skajshme ose ato të varfëra mund të kërkojnë që të paguajnë më shumë se 5% nga të ardhurat e tyre për shërbimet e ujit. Të ardhurat familjare të përdorura ishin të ardhurat mesatare të vendit, siç tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3. Shpërndarja e supozuar e të ardhurave për analizat e përballueshmërisë

Kategoria e të ardhurave				
	Njësia	Mesatare	Të varfër	Në varfëri të skajshme
Të ardhurat ditore për person	EUR	2.42	1.72	1.2
Të ardhurat mujore për familje	EUR	363	258	180
Të ardhurat mujore për familje duke përfshirë remitencat dhe ekonominë joformale	EUR	555	395	275

Burimi: SF për ITUZ në Pejë, SECO, 2014

E ardhura mesatare mujore e adoptuar e një familje në Kosovë ishte 555 Euro, e cila shumë ishte llogaritur duke rritur pagën mesatare të sektorit publik prej 363 Euro me 8% të ardhura nga remitencat dhe 45% nga ekonomia joformale. Llogaritja e njëjtë është aplikuar tek të ardhurat e familjeve të varfëra dhe atyre në varfëri të skajshme, të cilat janë vlerësuar me të ardhura mesatare vjetore prej 395 Euro dhe 275 Euro.

Tabela në vijim paraqet tarifat dhe faturat mujore përkatëse të ujit të cilat janë përdorur si bazë për analizën e përballueshmërisë për ITUZ në Pejë.

Tabela 4. Tarifat dhe faturat e ujit (me dhe pa TVSH prej 16%) të përdorura për analizat e përballueshmërisë për normën aktuale të arkëtimit prej 64% për Opsionin 3.

	Njësia	Opsioni 3
Tarifat (pa VAT)		
Tarifa shtëpiake e ujit të pijshëm (aktuale)	Euro/ m3	0.23
Tarifa fikse (aktuale)	Euro/ muaj	1.00
Tarifa e grumbullimit të ujërave të zeza (e rregulluar)	Euro/ m3	0.32
Tarifa uniforme e trajtimit të ujërave të zeza	Euro/ m3	0.60
Tarifa jo-uniforme e trajtimit të ujërave të zeza	Euro/ m3	0.79
Fatura e Ujit (pa VAT)		
Fatura mujore e ujit (uniforme)	Euro/ muaj	18.4
Fatura mujore e ujit (jo-uniforme)	Euro/ muaj	21.1
Fatura e Ujit (me VAT)		
Fatura mujore e ujit (uniforme)	Euro/ muaj	21.3
Fatura mujore e ujit (jo-uniforme)	Euro/ muaj	24.5

Burimi: SF për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Zeza në Pejë, 2014, SECO

Sipas **Tabelës 3**, fatura mujore e ujit për një familje mesatare me pesë persona dhe një konsum uji mesatar prej 15 m3/ muaj (100 litra për kokë banori në ditë) ka variuar nga 18.4 Euro (uniforme, pa TVSH) në përafërsisht 24.5 Euro (jo-uniforme, me TVSH).

Përballueshmëria e tarifave uniforme dhe jo-uniforme është përmbledhur në tabelën e mëposhtme, veçmas për tri nivelet e ndryshme të të ardhurave për Opsionin 3.

Tabela 5. Përballueshmëria e tarifave uniforme dhe jo-uniforme të ujit dhe të ujërave të zeza për familjet mesatare, të varfëra dhe në varfëri të skajshmë për Opsionin 3.

	Njësia	Mesatare	Të varfër	Në varfëri të skajshme
Fatura mujore e ujit (uniforme)	EUR/month	21.3	21.3	21.3
Pjesa e të ardhurave	%	3.8%	5.4%	7.7%
Fatura mujore e ujit (jo-uniforme)	EUR/month	24.5	24.5	24.5
Pjesa e të ardhurave	%	4.4%	6.2%	8.9%

Burimi: SF i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Zeza në Pejë, 2014, SECO

Analizat e mësipërme tregojnë që adoptimi i **qasjes së tarifës jo-uniforme** do rezultonte në atë që tarifat të mos jenë të përballueshme për grupet e varfëra dhe ata në varfëri të skajshme, të cilët së bashku **përfaqësojnë rreth 40%** (30% të varfër, 10% në varfëri të skajshme) të popullësisë së Kosovës.

Megjithatë, me miratimin e **qasjes së tarifës uniforme**, tarifa mujore e ujit dhe ujërave të zeza është e përballueshme për grupet familjare mesatare dhe pak a shumë e përballueshme për grupet familjare të varfëra, d.m.th. në përgjithësi e përballueshme për rreth **90% të popullësisë së Kosovës**. Kjo thekson rëndësinë e masave për ndarjen e barrës në mes të këtyre tri grupe të ndara sipas të ardhurave.

5.3.4 Pranimi Socio-Kulturor dhe Gatishmëria për të Paguar

Në kuadër të Studimit të Fizibilitetit për ITUZ në Pejë, është bërë vlerësimi i kënaqësisë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga KRU Hidrodrini, vlerësimi i vetëdijësimit të konsumatorëve për nevojën e trajtimit të ujërave të zeza dhe pasojat higjienike dhe mjedisore të shkarkimit të ujërave të zeza të patrajuara, dhe poashtu pritjet dhe gatishmëria e konsumatorëve për të paguar për trajtimin e ujërave të zeza.

Ky vlerësim është bazuar kryesisht nga rezultatet e takimeve të fokus grupeve të mbajtura në Pejë¹⁹, të cilat kanë përfshirë:

- Konsumatorë nga qyteti i Pejës të cilët do kenë qasje në ITUZ e planifikuar
- Konsumatorë nga qendrat urbane të Klinës, Istogut dhe Deçanit të cilët nuk do të kenë qasje në ITUZ e planifikuar, por kanë qasje në sistem të kanalizimit dhe do pritjet që do paguajnë tarifat uniforme në përputhje me politikën tarifore aktuale të ZRRUK.

Shumica e pjesëmarrësve në tri takimet e fokus grupeve e konsideruan të rëndësishme përmirësimin e shërbimeve për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza për këto arsye:

- Përhapja e sëmundjeve, p.sh. përmes infiltrimit të ujërave të zeza në ujërat nëntokësor;
- Ndotja mjedisore e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor. Rreth 80% e pjesëmarrësve ishin të vetëdijshëm që pjesa e përdorur e ujit për ujitje vjen nga lumenjtë apo kanalet e ndotura nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajuara. Përveç kësaj, një shqetësim tjetër që ata theksuan ishte edhe flora dhe fauna në lumenjtë lokal e veçanërisht rreziku i zhdukjes së të ashtuquajturës "troftës vendase".

Rezultatet nga takimet me fokus grupet treguan se popullata në përgjithësi është në dijeni për përfitimet mjedisore si rezultat i trajtimit të ujërave të zeza. Megjithatë, pjesëmarrësit qartazi kërkuar **fushata ndërgjegjësimi**, në veçanti duke u fokusuar tek njerëzit më pak të edukuar/informuar. Komunikimi duhet të ketë qëllim përmirësimin e kuptimit të përgjithshëm për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini. Pjesëmarrësit në takimet e fokus grupeve poashtu përmenden keqkuptime për bindjen e gabuar se një impiant i trajtimit të ujërave të zeza do ndikonte pozitivisht në cilësinë e ujit të pijshëm.

Fokus grupet treguan se popullësia **aktualisht nuk është e njohur me Parimin Ndotësi Pagan. Kjo mund të ndikoj negativisht në gatishmërinë për të paguar tarifat uniforme për ujërat e zeza. Prandaj është rekomanduar në SF të komunikohet dhe shpjegohet në mënyrë aktive Parimi Ndotësi Pagan si pjesë e rritjes së ndërgjegjësimit publik.** Shihni sesionin 4.6.2. në këtë raport.

¹⁹ Kryer nga Znj. Vera Muhaxhiri, bashkë-autorja e këtij raporti, e cila ka qenë e angazhuar nga Ernst Basler and Partner Ltd si eksperte lokale financiare për përgatitjen e SF të ITUZ Pejë, në vitin 2014..

5.4 Ndikimi i Qasjes së Tarifës Uniforme në Rajonin e Gjakovës

Studimi i Fizibilitetit, i bërë në vitin 2013, i financuar nga SECO, për ITUZ në Gjakovë është kryer nga të njëjtit Konsulentë²⁰ të cilët kanë përgatitur Studimin e Fizibilitetit të vitit 2014 të financuar nga SECO për ITUZ të ri në Pejë. Konsulentët kanë përdorur metodologjinë e njëjtë për zhvillimin e tarifave dhe analizat e përballueshmërisë në dy studimet duke përfshirë krahasimin e çështjeve të përballueshmërisë për qasjen e tarifës uniforme dhe lokale për shërbimet e ujërave të zeza. Konkludimet për rëndësinë e qasjes së tarifës uniforme për rajonin e Gjakovës janë të ngjajshme me ato të nxjerra në sesionin e mësipërm (d.m.th. për rajonin e Pejës) andaj nuk përsëriten në këtë sesion.

5.5 Rritja e Ndërgjegjësimit Publik për Çështjet e Ndotjes Mjedisore

5.5.1 Hyrje

Aktualisht, ekzistojnë iniciativa modeste nga institucionet qeveritare dhe OJQ në Kosovë për rritjen e përgjithshme të ndërgjegjësimit publik për çështjet e ndotjes mjedisore.

Asnjë nga KRU nuk implementojnë masa profesionale apo të rregullta për informim publik dhe nuk organizojnë aktivitete për ndërgjegjësim publik në lidhje me ndikimin që trajtimi i ujërave të zeza ka në shëndetin dhe financat e njerëzve. Prandaj është shumë e rëndësishme që KRU të krijojnë kanale efektive të informimit dhe ndërgjegjësimit publik të cilat i ndihmojnë atyre në rritjen e vizibilitetit në përgjithësi dhe për çështjet e lidhura me mjedis në veçanti.

Me qëllim të implementimit të Fushatave për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik rekomandohet që KRU së pari të kryejnë një anketë me konsumatorët e cila do të ndihmonte në identifikimin e masave të kërkuara për rritjen e ndërgjegjësimit të cilat do të implementohen gjatë Fushatave për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik.

5.5.2 Masat për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik

TeR përfshijnë kërkesën për të ofruar rekomandime konkrete për KRU dhe palët tjera të interesit duke përfshirë mënyrën se si të përmirësohet angazhimi i tyre me konsumatorët shtëpiak dhe të rritet ndërgjegjësimi i çështjeve të ndotjes së mjedisit bazuar në Parimin Ndotësi Pagan.

Këtë çështje e adresojnë paragrafët vijues të këtij sesioni të raportit.

Për të krijuar Fushata efektive dhe të qëndrueshme për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik, duhet të adresohen aspektet mjedisore, sociale dhe financiare të konceptit të ndotjes së mjedisit/ trajtimit të ujërave të zeza dhe duhet të targetohen të gjithë sektorët e publikut. Fushatat për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik duhet të implementohen në koordinim me palët e interesit kyçe të mjedisit.

Mjetet kryesore të komunikimit me publikun/konsumatorët duhet të jenë përmes mediave lokale dhe shtetërore, veçanërisht TV dhe radio stacionet, të cilat mund të transmetojnë

²⁰ Ernst Basler and Partner Ltd.

përmbajtjen e informatave të cilat do përgatiten nga ekipi për rritjen e ndërgjegjësimit publik.

Institucionet dhe organizatat e mundshme lokale dhe kombëtare të cilat mund të përfshihen në programin e ndërgjegjësimit janë të renditura më poshtë:

- KNMU
- MZHE
- IKShP/ Këshilli për Përmirësim të Shëndetit Regjional
- MMPH/Autoriteti i Pellgjeve Lumore (APL)
- KRU
- Asociacioni i Komunave (AiK)
- ZRRUK
- SHUKOS
- Komisioni Konsultativ për Klientin
- OJQ
- RTK (stacioni kombëtar televiziv)
- Stacionet lokale televizive
- Përfaqësuesit nga komuniteti i donatorëve në sektorin e ujërave

Ky aktivitet do ishte më së miri të fillohej nga Këshilli Ndërmintor i Ujërave (KNMU) apo SHUKOS. Mund të krijohet një Grup Punues (GP) i përbërë nga institucionet/organizatat e mësipërme. Duhet të hartohet një Plan Veprimi për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik nga ky GP duke përfshirë të gjitha informatat dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit publik të aprovuara nga Komiteti Drejtues i cili do përbëhet nga palët kyçe si KNMU, MMPH/APL, MZHE, AiK dhe SHUKOS.

Plani i Veprimit për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik duhet të ofroj masa specifike se si të transmetoj këtë informacion:

- Informata të përgjithshme dhe specifike për ndotjen e ujërave të zeza dhe parimin ndotësi pagan;
- Informata për nevojat e trajtimit të ujërave të zeza dhe komponentet e tyre d.m.th. kostot dhe përfitimet e lidhura me trajtimin e ujërave të zeza me qëllim të rritjes së gatishmërisë për të paguar dhe për të rritur besimin në cilësinë e mirë të furnizimit me ujë, të shërbimeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;
- Informata lidhur me progresin e Projekteve specifike lidhur me Trajtimin e Ujërave të Zeza;
- Informata për përdorimin sa më ekonomik të ujit të pijshëm me qëllim të zvogëlimit të gjenerimit të ujërave të zeza, të cilat do kishin një ndikim direkt në shumën e zvogëluar të një fature të ujit;
- Nga Takimet e Fokus Grupit të mbajtura në Pejë²¹ u bë e qartë që **konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë tarifa të ujit dhe ujërave të zeza të rritura, me kusht që të përmirësohet cilësia e shërbimeve**. Andaj, si bazë për ndërgjegjësimin e rritur për tarifat dhe gatishmërinë për të paguar, masat duhet që rregullisht të ofrojnë informata për progresin e cilësisë së shërbimit të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza përmes Raporteve të Performancës së ZRRUK.

²¹ Studimi i Fizibilitetit për ITUZ në Pejë

- Nga një perspektivë afat-gjatë, do ishte shumë e dobishme të targetohej gjenerata më e re për rritjen e ndërgjegjësimit, në veçanti studentët e shkollave të mesme dhe të larta.

6 PËRMBLEDHJE E PËRVOJËS ME POLITIKËN TARIFORE TË UJËRAVE TË ZEZA NE VENDET TJERA RAJONALE DHE MËSIMET E NXJERRA

6.1 Hyrje

Ky sesion i raportit përmbledhë përvojën e vendeve tjera rajonale me çështjet e politikave tarifore të ujërave të zeza dhe nxjerrë disa mësimet.

Asnjë nga pjesët e Legjislacionit primar apo Metodologjisë së tarifave apo udhëzimet/ rregullat e shqyrtuara më poshtë nuk i referohet në mënyrë direkte adoptimit të një qasje të tarifës uniforme për shërbimet me ujëra të zeza dhe asnjë nga vendet rajonale përveç Shqipërisë nuk duket se kanë dokumente të politikave mirë të definuara dhe të detajuara, krahasuar me dokumentet e politikës tarifore të ZRRUK të zhvilluara në vitin 2008 dhe të shqyrtuara në Mars 2011.

6.2 Shqipëria

Shqipëria ka një strukturë institucionale të sektorit të ujit relativisht mirë të zhvilluar duke përfshirë një Rregullator për Ujë dhe Ujëra të Zeza të pavarur ekonomik (ERRU) dhe 58 ndërmarrje të ujit dhe ujërave të zeza në pronësi të Komunave, duke përfshirë një numër të ITUZ të mandatuara së fundi në qytetet më të mëdha. Politika e përcaktimit të tarifave të ujit dhe ujërave të zeza përcaktohet nga ERRU në pajtim me Ligjin 8102.

Ligji primar i Shqipërisë Nr 8101 me datë 28/03/1996, i titulluar "Kudri Rregullator i Furnizimit me Ujë dhe Grumbullimit dhe Largimit të Ujërave të Zeza", ofron një kornizë për rregullimin e sektorit të ujit dhe ujërave të zeza në Shqipëri duke përfshirë përcaktimin dhe aprovimin e tarifave nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU). Udhëzimet për Përcaktimin e Tarifave të lëshuara nga ERRU në Shtator të vitit 2011 përfshijnë Objektivat Politike të tij në Nenin 4, i cili i referohet limiteve të përballueshmërisë duke u bazuar në praktikë të mirë ndërkombëtare. Megjithatë, Udhëzimet nuk bëjnë ndonjë referencë të qartë për adoptimin e tarifave *uniforme* për ujë dhe ujëra të zeza në gjithë zonën e shërbimit të 58 kompanive të ujit dhe ujërave të zeza aktualisht të rregulluara nga ERRU.

Raporti Vjetori i Performancës i vitit 2013 për Ndërmarrjet për Furnizim me Ujë dhe Shërbime të Ujërave të Zeza tregon se gjatë 3 viteve të fundit (2011- 2013), tarifat për konsumatorët shtëpiak mesatar janë rritur për 14% për furnizim me ujë dhe 25% për shërbime të ujërave të zeza. Nuk dihen reagimet e konsumatorëve të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza në Shqipëri për këto rritje në tarifa. Megjithatë, parimisht dihet në përgjithësi se rritjet e vogla të rregullta janë më të pranueshme për konsumatorët sesa rritjet e mëdha në tarifa, veçanërisht nëse konsumatorët janë gjithashtu në dijeni për përmirësimet e shtuara në nivelin e shërbimit që lidhet me rritjen e tarifave.

Gjatë diskutimeve në Tiranë, në muajin Prill 2015, me kolegët dhe Kryesuesin e ERRU duke përfshirë anëtarët e Komisionit Kombëtar dhe Drejtorin e Drejtoratit Teknik dhe Ekonomik të ERRU, janë diskutuar pikat kyçe në lidhje me përvojën e Shqipërisë me çështjet e tarifave të ujërave të zeza dhe përballueshmërisë:

- Politika tarifore për ujë dhe ujëra të zeza në Shqipëri mbulohet nga legjislacioni primar ekzistues së bashku me legjislacionin sekondar të lëshuar nga ERRU.

- Udhëzimet tarifore së bashku me dokumentet e brendshme të ERRU përshkruajnë metodologjinë tarifore që aplikohet tek ndërmarrjet e ujit dhe ujërave të zeza në Shqipëri.
- Politika tarifore përfshin dy karakteristika të brendshme të subvencioneve:
 - Ndërsubvencionet në mes të grupeve të ndryshme të konsumatorëve
 - Subvencionet e aplikuara nga ndërmarrjet në kategorinë më të varfër të konsumatorëve
- Çdo propozim i ndërmarrjeve për tarifën e ujit dhe ujërave të zeza konsiderohet në baza 'rast pas rasti' nga ERRU gjatë procesit të përcaktimit të tarifave vjetore. Megjithatë, kostot operative dhe mirëmbajtëse të ITUZ pritet të ndahen me të gjithë konsumatorët e ndërmarrjes dhe njihet se ndikimi i një ITUZ shtrihet në mjedis më të gjërë dhe jo në ndonjë konsumator individual (d.m.th. është e zbatueshme një politikë tarifore uniforme e nënkuptuar).
- Një qasje rritëse konsiderohet e përshtatshme për rritjen e tarifave për të zbutur përbalueshmërinë dhe gatishmërinë e pagimit të faturave. Aproximativisht vjetor i tarifave të ndërmarrjes nga ERRU varet nga secila performancë e raportuar/audituar e kompanisë kundrejt caqeve për një sërë treguesish kyç të performancës (TKP). Atyre ndërmarrjeve që arrijnë apo tejkalojnë objektivat e vendosura për TKP i'u lejohet të rrisin tarifën në bazë të një formule për rregullimin e tarifave.
- Konsumatorët në përgjithësi janë më të gatshëm të paguajnë ngarkesat e rritura për shërbimet e ujërave të zeza nëse performanca e përgjithshme e kompanisë është duke u përmirësuar ("rreth virtuos").
- Për shumicën e ndërmarrjeve të vogla të ujit dhe ujërave të zeza në Shqipëri (<50,000 persona), objektivi i ITUZ të reja dhe të propozuara është të shërbejnë të gjithë zonën e shërbimit edhe pse në fazat fillestare disa kanalizime të konsumatorëve mund të mos jenë të lidhura me ITUZ.
- Për ndërmarrjet më të mëdha të ujit (>50,000 persona) p.sh. Tirana, Durrësi, Korça, Shkodra etj., zona shërbyese e kompanive dhe rrjeti i kanalizimit e tejkalon mbulimin me shërbim të ITUZ- p.sh. për Durrës:
 - 55% e k. janë të lidhura në ITUZ përmes rrjetit të kanalizimit
 - 35% e k. janë aktualisht të lidhura në rrjetin e kanalizimit por kanalizimet nuk janë akoma të lidhura me ITUZ.
 - 15% e k. nuk kanë aktualisht qasje në rrjetin e kanalizimit
 - Konsumatorët e mësipërm pa qasje në rrjetin e kanalizimit ngarkohen për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza. Megjithatë, sipas udhëzimeve të ERRU nëse ata mund t'ua dëshmojnë ndërmarrjeve që nuk janë të lidhura në një kanalizim, ata nuk ngarkohen për shërbimet e grumbullimit e as të trajtimit të ujërave të zeza.
- Tarifën e ujërave të zeza normalisht mbulojnë vetëm kostot operative dhe mirëmbajtëse (O+M) të trajtimit të ujërave të zeza- jo kostot kapitale.

- Si shkak i brengosjes për përballueshmërinë dhe gatishmërinë për të paguar faturat që dalin nga tarifat e rritura të ujërave të zeza për operimin e ITUZ të reja, Qeveria e Shqipërisë kohëve të fundit mandatoi një studim të përballueshmërisë për të shqyrtuar situatën lidhur me kostot/ politikën tarifore të ITUZ dhe për të bërë rekomandimet që përfshijnë opsionet për ndarjen e barrës nga konsumatorët më të varfër.
- Aktualisht kostot O+M të ITUZ nuk mbulohen tërësisht nga tarifat e ujërave të zeza. Në një afat të mesëm, një raport i Bankës Botërore ka rekomanduar një taksë mjedisore për të gjithë qytetarët për t'i lejuar Qeverisë të subvencionoj kostot e O+M të ITUZ. Në një afat të gjatë (2020), në përputhje me Parimin Ndotësi Pague, konsumatorët pritët që të ngarkohen me kostot O+M të ITUZ plus kostot e mbulimit të kapitalit.
- Ndërmarrjet që u shërbejnë >50,000 personave kërkohen që përmes metodologjisë së tarifave të mbajnë takime publike për të justifikuar ndonjë propozim për rritje të tarifave.
- Skemat aktuale ndajnë subvencione përmes ndërmarrjeve për pagimin e ngarkesave të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza për konsumatorët më të varfër. Në të ardhmen subvencionet do paguhen direkt nga Qeveria për familjet me të ardhura të ulëta duke u bazuar në kriteret e detajuara dhe kjo kërkon bashkëpunim në mes të njësive të Qeverisë Lokale dhe Qendrore.
- Një strukturë fleksibile dhe relativisht e sofistikuar e bllok tarifës duke u bazuar në konsum është prezantuar me sukses së fundi nga Ndërmarrja e Pogradecit për të mbështetur familjet me të ardhura të ulëta, duke rezultuar në një rritje prej 12% në të ardhura për ndërmarrjen, sipas informatave të ERRU. Ndërmarrja e Korçës është gjithashtu e interesuar të aplikojë strukturën e bllok tarifës. Kërkesat thelbësore për implementimin e suksesshëm të një strukture të bllok tarifës nga ERRU konsiderohen:
 - Një databazë e saktë e konsumatorëve të ndërmarrjes
 - Gatishmëria e ndërmarrjes për të implementuar bllok tarifat duke përfshirë implikimet administrative
 - Përqindja e lartë (100% e k) e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës
 - Justifikim i fortë financiar për qasjen e bllok tarifave duke u bazuar në një raport të opsioneve të tarifave
 - Mbështetja institucionale për dizajn të jashtëm dhe implementim të bllok tarifave (KfW ka mbështetur përgatitjen e propozimit të bllok tarifave të Ndërmarrjes së Pogradecit)
- Deri më sot ERRU nuk ka pranuar ndonjë ankesë specifike lidhur me aplikimin e një tarife uniforme të ujërave të zeza.

6.3 Bosnja dhe Hercegovina

Draft strategjia e përcaktimit të tarifave dhe pozicionimi më i mirë i trupit rregullator për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza në Bosnje-Hercegovinë nga Konsulentët e UNDP në Janar 2015 është siguruar nga ZBZ në Prishtinë nëpërmjet UNDP. Përderisa ky dokument akoma nuk është finalizuar (dhe nuk është në dispozicion për publik) është shqyrtuar shkurtimisht si pjesë e këtij studimi aktual.

Si një përmbledhje, dokumentacioni përmban:

- Draft studimin për pozicionimin më të mirë të trupit rregullator për procesin e përcaktimit të tarifave në muajin Janar 2015
- Draft metodologjinë e tarifave për furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza në BH në muajin Shkurt 2015

Metodologjia tarifore përfshin një shqyrtim të detajuar të qasjeve të ndryshme të metodologjive të përcaktimit të tarifave dhe financimit të shërbimeve të ujit (dhe ujërave të zeza) në vendet dhe rajonet tjera të cilat përfshijnë Shqipërinë dhe Kosovën dhe poashtu njëmbëdhjetë vende tjera më të avancuara duke përfshirë Britaninë e Madhe, Gjermaninë dhe Zvicrën.

Megjithatë, draft metodologjia e tarifave koncentrohet kryesisht në shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza me disa referenca specifike për trajtimin e ujërave të zeza dhe pa pasur në konsideratë politikën tarifore uniforme apo ndonjë formë tjetër të politikës.

6.4 Maqedonia

Aktualisht nuk ka rregullator, andaj tarifat vendosen nga Këshilli i Komunës me kërkesë të ndërmarrjes/ kryetarit.

Draft dokumentet vijuese janë përcjellur nga ZBZ në Prishtinë, të cilat përmbajnë:

- Draft Ligjin për përcaktimin e çmimeve për shërbimet e ujit- versioni i draftit final i Nëntorit 2014
- Draft Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Dhjetor 2014
- Planin e Veprimit 2014

Draft Ligji për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Nenin 7 thekson që *"Tarifat për ofrimin e trajtimit të ujërave të zeza nga ofruesi i shërbimit të ujit, duhet të krijohen për secilin konsumator individualisht, duke u bazuar në një tarifë të thjeshtë volumetrike siç përshkruhet në Nenin 5, paragrafi 2, e ndryshuar për ngarkesën e ndotjes së shkarkuar nga konsumatori"*.

Ky Nen është në përputhje me Parimin Ndotësi Pague por për arsye praktike dhe logjistike vlerësimi individual i ngarkesës së ndotjes konsiderohet i vështirë apo i pamundur të zbatohet në mënyrë efektive për konsumatorët shtëpiak dhe nuk merret në konsideratë në asnjë detaj në raport.

6.5 Mësimet e nxjerra për përvojën rajonale të tarifave të ujërave të zeza

Përvoja rajonale siç është konfirmuar së fundi nga ERRU në Shqipëri lidhur me tarifat e ujërave të zeza dhe me gatishmërinë për të paguar faturat konsiderohet si më e rëndësishmja për kontekstin e Kosovës dhe sesi i mësipërm 5.2. thekson pikat kryesore.

Disa mësimet e rëndësishme për t'u mësuar janë përmbledhur më poshtë dhe konteksti i Kosovës është shfaqur në stilin e shkronjave *'italic'* për secilën pikë:

- **Qasja Hap pas hapi** konsiderohet e përshtatshme në Shqipëri për rritjen e tarifave gjatë disa viteve në vazhdimësi me qëllim të zbutjes së përballueshmërisë dhe gatishmërisë së pagesës së faturave. *Kjo qasje rritëse është poashtu e aplikueshme në rritjet e tarifave të ujërave të zeza në Kosovë për të mbuluar kostot e O+M të ITUZ.*
- **Konsumatorët në Shqipëri janë në përgjithësi më të gatshëm të paguajnë ngarkimet e rritura për shërbimet e ujërave të zeza nëse gjendja e përgjithshme e kompanisë tregon se po përmirësohet** (një rreth virtuoze). *Ky është një konkluzion i qartë por megjithatë duhet të njihet plotësisht nga KRU e Kosovës dhe të tjerë palë të interesit. Për më tepër, takimet e fokus grupeve të mbajtura gjatë SF për ITUZ në Pejë e përforcojnë këtë mesazh.*
- **Ndërmarrjet në Shqipëri të cilat i shërbejnë >50,000 personave kërkohen që përmes metodologjisë tarifore të mbajnë takime publike** për të justifikuar ndonjë propozim për tarifën e rritura dhe të u'a mundësojnë konsumatorëve të diskutojnë për çështjen. *Nga KRU në Kosovë poashtu kërkohet të mbahen takime publike për të justifikuar propozimet e tyre tarifore. Megjithatë në Kosovë dhe Shqipëri sipas ERRU dhe ZRRUK, duhet të bëhen përmirësime në reklamim dhe mbajtje të takimeve publike për të marrë shënime të duhura për shqetësimet e konsumatorëve.*
- **Një strukturë fleksibile e bllok tarifës në Shqipëri** që bazohet në konsum është adoptuar në mënyrë të suksesshme nga Ndërmarrja e Pogradecit për të mbështetur familjet me të ardhura të ulëta, dhe kështu duke rezultuar në një rritje prej 12% në të hyrat e ndërmarrjes, sipas informatave të ERRU. ZRRUK dhe KRU e Kosovës mund të mësojnë nga përvoja e lartëcekur pozitive e Pogradecit sa i përket adoptimit të bllok tarifës për të ndihmuar adresimin e çështjeve të përballueshmërisë dhe poashtu për të rritur arkëtimin e parasë së gatshme. *Shënim: Politika për përcaktimin se si konsumatorët e varfër mund të ndihmohen për të paguar faturat e tyre është çështje që i takon ekzkluzivisht Qeverisë së Kosovës (d.m.th. jo përmes Politikës Tarifore të ZRRUK). Për më tepër një shqyrtim i detajuar i aranzhimeve të bllok tarifave të adaptuara kohëve të fundit nga Ndërmarrja e Pogradecit konsiderohet jashtë fushëveprimit të këtij shqyrtimi (raporti). Shihni **Shtojcën D** për një përmbledhje të tarifave të ujit dhe ujërave të zeza në Shqipëri në vitin 2014 nga uebfaqja e ERRU duke përfshirë bllok tarifën e ujit dhe ujërave të zeza në ndërmarrjen e Pogradecit.*

7 KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Përgjithshme

7.1 Konkluzionet

Pas konsultimit me një gamë të gjërë të palëve të interesuara në Kosovë dhe më tepër pas diskutimit të gjetjeve dhe rekomandimeve finale me palët e interesit në takimin e tryezës së rrumbullakët të datës 23 Qershor 2015 duket se ekziston një pajtim i përgjithshëm që qasja ekzistuese e tarifës uniforme (në përputhje me Politikën e Ujërave të Kosovës dhe me Politikën Tarifore për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza të Zyrës Rregullore për Ujësjellës dhe Kanalizim), gëzon një përkrahje të gjërë nga palët e interesuara dhe është qasja e politikës tarifore më e përshtatshme për ujëra të zeza për disa arsye:

- Nuk është diskriminuese për konsumatorët, në cilëndo KRU që pranojnë shërbimet e njëjta të ujërave të zeza;
- Është në pajtueshmëri me PNP;
- Është në pajtueshmëri me sesionet e Politikës së Ujërave të Kosovës dhe kërkesat e Politikës Tarifore të ZRRUK;
- Rezulton në tarifa të përgjithshme më të ulëta të ujërave të zeza në krahasim me tarifat lokale;
- Shpërndan kostot O+M të ITUZ tek të gjithë konsumatorët me qasje në kanalizimet e KRU e cila ndihmon në lehtësimin e çështjeve të përballueshmërisë për familjet me të ardhura të ulëta;
- Shmang rritjet e mëdha të tarifave lokale sa herë që janë të nevojshme investimet kapitale për renovime apo përmirësime;
- Arrin stabilitetin e të ardhurave;
- Zvogëlon kostot administrative të KRU dhe kostot rregullore të ZRRUK gjatë periudhës së shqyrtimeve të tarifave.

Përveç kësaj, më poshtë janë të përmbledhura disa avantazhe tjera strategjike të një qasje të tarifës uniforme, por nuk merren në konsideratë më tej në raport:

- Ofron nxitje për rajonalizimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të kompanisë;
- Adreson çështjet e vogla - të qëndrueshmërisë së sistemit;
- Inkurajon investime në zgjerimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza nga KRU²²;
- Inkurajon mundësinë e përfshirjes private në sektorin e ujërave.

Megjithatë, janë disa mësimet të dobishme për tu mësuar, sidomos nga përvoja e tarifave të ujit dhe ujërave të zeza të Shqipërisë p.sh. përfitimet e rritjes graduale të tarifës.

²² Mund të vihet në përfundim që nëse të gjithë konsumatorët që kanë qasje në rrjetin e kanalizimit të KRU paguajnë për operimin dhe mirëmbajtjen e ITUZ përmes tarifës uniforme atëherë nuk ka asnjë nxitje/arsye për të financuar apo operuar ITUZ shtesë. Megjithatë, donatorët kanë gjasa t'i shohin KRU më të favorshme për investime të ardhshme në ITUZ dhe rrjete kanalizimi ku aplikimi i një tarife uniforme i mundëson mbulimin e kostove O&M pa tejkaluar limitet e përballueshmërisë, përveç tek rasti me familjet me të ardhurat më të ulëta. Për më tepër, zgjerimi i ITUZ ekzistues për të arritur një mbulim më të madh duke përfshirë zonat me infrastrukturë kanalizimi për herë të parë si dhe sigurimin e trajtimit të ujërave të zeza për ata konsumatorë me qasje të cilët deri tani nuk kanë pasur qasje në një ITUZ duhet të ofrojnë tarifa uniforme më të ulëta si rezultat i ekonomisë të shkallës dhe mbulueshmërisë së rritur.

Përveç kësaj, janë disa çështje shumë të rëndësishme "të ndjeshme" të cilat duhet të adresohen urgjentisht p.sh. angazhimi efektiv i konsumatorëve të secilës KRU për çështjet e tarifës së ujërave të zeza, rritja e ndërgjegjësimit publik për çështjet e PNP nga Qeveria Qendrore dhe palët tjera, dhe nevoja për subvencione qeveritare për familjet me të ardhura të ulëta etj.

7.2 Rekomandime të përgjithshme

Ky raport rekomandon masat vijuese në lidhje me politikën tarifore të ujërave të zeza dhe përballueshmërinë/ gatishmërinë për të paguar faturat - të gjitha këto do diskutohen dhe finalizohen në një tryezë të rrumbullakët me palët e interesuara të sektorit të ujërave:

1. **Vazhdimi me politikën ekzistuese tarifore për ujë dhe ujëra të zeza në formën aktuale siç përcaktohet në Politikën Tarifore të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim Nr. 5 ("tarifat uniforme për shërbimet e ujit dhe ujërat e zeza për të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin e kanalizimit të Kompanisë Rajonale të Ujit").**
2. Marrja në konsideratë e qasjes sipas pellgjeve lumore të tarifave uniforme për ujërat e zeza të jenë pjesë e konsolidimit të mëtejshëm të shtatë Kompanive Rajonale të Ujit, në 3 ose 4 kompani më të mëdha rajonale, në një afat të mesëm.
3. Ngritja e vetëdijësimit²³ dhe të kuptuarit e Parimit Ndotësi Paguan me qytetarët në Kosovë përmes një fushate të koordinuar nga Qeveria Qendrore dhe Lokale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kompanitë Rajonale të Ujit dhe Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, me përkrahje nga donatorët kryesor të sektorit të ujit, në mënyrë që të ndihmohet adresimi i mungesës së gatishmërisë për të paguar tarifa shtesë për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza (veçanërisht nga konsumatorët të cilët janë të lidhur në kanalizimin e Kompanisë Rajonale të Ujit por jo të lidhur -në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza).
4. ZRRUK të marr në konsideratë lejimin e rritjes graduale²⁴ të tarifave të ujërave të zeza përpara se të bëhet pranimi i FTUZ, por vetëm pasi që KRU relevante të demonstrojnë përmirësime të qëndrueshme të performancës së tyre kundrejt caqeve specifike të aprovuara nga ZRRUK (p.sh. zvogëlimi i UPF, përmirësimi i efikasitetit të arkëtimit, No. i çkyçjeve të konsumatorëve illegal etj.) si gjë e nevojshme për aprovimin e tarifave rritëse të ujërave të zeza.

²³ Fokus grupi i cili ishte intervistuar gjatë SF për Pejën ka treguar që ekziston një injorancë e përgjithshme për PNP dhe një mosgatishmëri nga ana e konsumatorëve për të paguar për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza veçanërisht kur kanalizimi i tyre nuk do të jetë i lidhur me ITUZ. Rezistenca nga konsumatorët për të paguar tarifa më të larta për shërbime më të mira të ujërave të zeza është një karakteristikë globale veçanërisht nga konsumatorët e varfër, gjë që mund të adresohet vetëm nga Qeveria e cila mund të i ndihmojë konsumatorët e varfër për të paguar faturat e tyre, pastaj përmes rritjes graduale të tarifave për shërbimet e ujërave të zeza, si dhe në të njëjtën kohë të ngisin vetëdijen e konsumatorëve për çështjet e ndotjes dhe ndikimeve ambientale dhe ekonomike në nivelin lokal dhe më gjërë të mostrajtit të ujërave të zeza përmes Programeve të vetëdijësimit publik.

²⁴ Eksiton mundësia në rregullat tarifore në ZRRUK të ndryshohen tarifat çdo vjet nëse kjo është e nevojshme. Megjithatë, nga ky rishikimi nuk është kërkuar që të analizohet struktura tarifore në detaje.

5. ZRRUK të zhvillojë masat për të nxitur²⁵ Kompanitë Rajonale të Ujit të përmirësojnë performancën e tyre duke u bazuar në atë se konsumatorët në përgjithësi janë më të gatshëm të paguajnë tarifa më të rritura për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza nëse performanca e përgjithshme e kompanisë vazhdon të përmirësohet (një "rreth virtuoze").
6. ZRRUK dhe Enti Rregullator për Ujë i Shqipërisë duhet të vazhdojnë të mbajnë lidhjen për së afërmi²⁶ dhe të ndajnë përvojat e tyre mbi çështjet e përbashkëta duke përfshirë tarifat e ujërave të zeza, përballueshmërinë dhe gatishmërinë për të paguar faturat, përfitimet për familjet me të ardhura të ulta dhe nivelet e grumbullimit të parasë së gatshme me prezantimin e bllok tarifave, aty ku rrethanat lejojnë.
7. Çështjet e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për trajtimin e ujërave të zeza dhe Parimi Ndotësi Pague duhet të ngriten nga iniciativa specifike - shihni sesionin 4.6.2.

7.3 Rekomandimet Lidhur me Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik

Rekomandimet për ngritjen e ndërgjegjësimit publik dhe zhvillimin e një fushate të ndërgjegjësimit publik janë të përshkruara në sektorin 4.5.2. dhe janë të përsëritura më poshtë:

Për të krijuar Fushata efektive dhe të qëndrueshme për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik, duhet të adresohen aspektet mjedisore, sociale dhe financiare të konceptit të ndotjes së mjedisit/ trajtimit të ujërave të zeza dhe duhet të targetohet i gjithë publiku.

Fushatat e Rritjes së Ndërgjegjësimit Publik duhet të implementohen në koordinim me palët kyçe të interesit për çështjet mjedisore.

Mënyrat kryesore të komunikimit me publikun/ konsumatorët mund të jenë përmes mediave lokale dhe shtetërore, veçanërisht stacioneve televizive dhe radiove, të cilët do të transmetonin përmbajtjen e informatave që do përgatiten nga ekipi për rritjen e ndërgjegjësimit publik.

Institucionet dhe organizatat e mundshme lokale dhe shtetërore të cilat do mund të përfshiheshin në programin e ndërgjegjësimit janë të renditura më poshtë:

- MZHE
- MMPH/APL
- IKShP/ Këshilli për Përmirësim të Shëndetit Regional
- KRU

²⁵ Masat e tilla stimuluese mund të përfshijnë përmirësimin e publicitetit medial dhe mbështetjen/pjesëmarrjen e Qeverisë gjatë publikimit të performancës vjetore të KRU, veprimet e Qeverisë përmes mbështetjes që MZHE mund të i ofrojë ZRRUK për të lejuar bonuset për Bordet dhe menaxhmentin e lartë në rast të përmirësimeve reale dhe të qëndrueshme të performancës, vlerësimi i të cilës do të duhet të kryhej nga auditorë të pavarur të menaxhuar nga ZRRUK dhe MZHE dhe për të konsideruar si veprim të fundit zëvendësimin e Bordeve dhe menaxhmentin e lartë në rastet e performancës së dobët të KRU ku mendohet se duhet përmirësuar performanca (p.sh. në rastet kur për dy vite me rradhë kompania gradohet me performancën e parë po të dytë më të ulët).

²⁶ Të gjithë rregullatorët veprojnë ndryshe në disa aspekte. Prandaj, ndarja e eksperiencave është gjithmonë produktive. Ekziston një dialog i mirë në mes të ZRRUK dhe ERU i cili mund të zhvillohet edhe më tutje.

- Komunat
- ZRRUK
- SHUKOS
- Komisioni Konsultativ për Klientin
- OJQ
- RTK (stacioni kombëar televiziv)
- Stacionet lokale televizive

Ky aktivitet do ishte më së miri të fillohej nga Këshilli Ndërmintor i Ujërave (KNMU) apo SHUKOS. Mund të krijohet një Grup Punues (GP) i përbërë nga institucionet/organizatat e mësipërme. Duhet të hartohet një **Plan Veprimi** për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik nga ky GP për të përfshirë të gjitha informatat dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit publik të aprovuara nga Komiteti Drejtues i cili do përbëhet nga palët kyçe si KNUMU, IKShP, MMPH/APL, MZHE, AiK dhe SHUKOS.

Plani i Veprimit për Rritjen e Ndërgjegjësimit Publik duhet të ofrojë masa specifike në mënyrën e transmetimit të informata të lidhura me të.

SHTOJCA A: ABSTRAKT I TER

Një abstrakt nga TeR që mbulon zhvillimin e sektorit të ujërave të zeza, përmbledhjen e kornizës financiare dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave së bashku me detyrat kryesore dhe dokumentet që do dorëzohen, paraqitet më poshtë për lehtësimin tuaj.

Zhvillimi i Sektorit të Ujërave të Zeza

Aktualisht ekziston vetëm një Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ) i vogël urban në Kosovë, i dizajnuar për një popullatë ekuivalente (PE) prej 10,000 persona, në Skënderaj. Kohëve të fundit, komiteti i donatorëve në mënyrë aktive ka qenë duke marrë parasysh mbështetjen e këtij nën-sektori. Për qytetet më të mëdha janë bërë studime të fizibilitetit.

Në vitin 2011 elaborimi i tri studimeve të fizibilitetit për Projektet e Trajtimit të Ujërave të Zeza në Prizren, Pejë dhe Gjakovë u financua nga KfW. KfW veçse ka siguruar financimin për ITUZ në Prizren ku edhe ka filluar ndërtimi i ITUZ në fillim të vitit 2014. Në vitin 2012, Bashkëpunimi Zviceran (përmes SECO) u pajtua të bashkë-financoj me KfW Impiantet e TUZ për Gjakovë dhe Pejë. SECO sponzorizoj studimet plotësuese të fizibilitetit (duke u fokusuar në aspektet institucionale) të studimeve teknike të fizibilitetit (nga KfW) për Gjakovë (Shtator 2013) dhe Pejë (Nëntor 2014).

Qëllimi i Qeverisë së Kosovës është të ndërtojë impiante moderne të trajtimit të ujërave të zeza në këto tri qytete dhe në tjera qytete të mëdha si Prishtina, Mitrovica, Gjlani dhe Ferizaji. ITUZ dhe sistemet e nevojshme të kanalizimit do të plotësojnë investimet paraprake dhe ato të vazhdueshme në objekte të reja të prodhimit dhe në rrjete të furnizimit me ujë.

Vështrimi i Kornizës Financiare

Aktualisht infrastruktura e sektorit të ujërave (të zeza) në Kosovë financohet nga tri burime kryesore: (i) konsumatorët e ujit, të cilët paguajnë indirekt përmes kompanive të ujësjellësit; (ii) Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK); dhe (iii) donacionet dhe grantet nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve prezent në Kosovë. Përveç kësaj, impianti i ri i trajtimit të ujit në Prishtinë është financuar përmes një kredie nga KfW.

Shtatë Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU) blejnë ujin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) përmes licensave të abstraksionit, më pas i furnizojnë konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet; grumbullojnë ujërat e zeza, dhe ku është e mundur i transferojnë ato tek impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, dhe e shkarkojnë efluentin në trupa ujore të afërta. KRU poashtu paguajnë për lejet e shkarkimit, duke u bazuar në Parimin "Ndotësi Pague" ²⁷. Konsumatorët paguajnë për këto shërbime përmes tarifave duke u bazuar në ujin e konsumuar dhe pagesat

²⁷ "Ndotësi Pague" është një koncept i menaxhimit mjedisor ku ndotësi ngarkohet me një shumë që është ekuivalente me shumën që do i kushtonte të parandalonte ndotjen e shkaktuar (apo të ndreqë dëmin e shkaktuar në mjedis nga ndotja). Andaj, në terma të thjeshtë, sa më i madh ndikimi i ndotjes në mjedis, ndotësi kërkohet të paguaj më shumë për ndotjen. Aplikimi i këtij parimi për ujërat e zeza nënkupton që konsumatori duhet të paguaj për shërbimet e ujërave të zeza të ofruara nga KRU që përfshijnë grumbullimin, trajtimin dhe kostot e shkarkimit, përmes një tarife të drejtë, bazuar në konsum, apo nëse ujërat e zeza janë të mbledhura por nuk ka komponent të trajtimit të ujërave të zeza, duhet të kërkohet të paguaj një ngarkesë ndotje më të madhe për të kompensuar dëmin ndaj mjedisit, i cili vjen si rezultat i shkarkimit të ujërave të zeza të patrajtuara.

mendohet të mbulojnë jo vetëm kostot operative por gjithashtu (një pjesë nga) kostot investive.

Në kushtet mbizotëruese në Kosovë, në veçani situatë e vështirë ekonomike dhe të ardhurat e ulëta të konsumatorëve shtëpiak, financimi i infrastrukturës së ujit nga tarifat ende paraqet një sfidë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për investimet në grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, për të cilat investime ekziston përballueshmëri dhe gatishmëri e kufizuar për të paguar tarifat për mbulim të plotë të kostove. Si pasojë, investimet në infrastrukturën e ujërave të zeza duhet të financohen të paktën për një periudhë afat-mesme me anë të granteve dhe/ose subvencioneve. Kjo situatë është veçanërisht në rastin e ITUZ të cilat kërkojnë investime shumë të rëndësishme. Në mënyrë të ngjajshme, sektorët e ujërave të zeza në Zvicër dhe në vendet tjera të Evropës Perëndimore kanë qenë të subvencionuara për shumë dekada.

Politika e Përcaktimit të Tarifave

Tarifat për shërbimin e ujit të pijshëm dhe shërbimin e ujërave të zeza përcaktohen nga ZRRUK. Në vitin 2008, ZRRUK lëvizi drejtë një procesi të shqyrtimit tarifar 3 vjeçar të bazuar në parashikimet e kostove operationale dhe mirëmbajtëse dhe një shumë për kthim në kapital (ROC), e mjaftueshme për të tërhequr investitorë si donatorë, institucione financiare dhe mundësisht sektorin privat në afat më të gjatë.

Me Politikën Tarifore ZRRUK ka krijuar një metodologji për llogaritjen e tarifave të ujit dhe ujërave të zeza që bazohet në Deklaratën e Politikës për Furnizim me Ujë dhe Shërbime të Ujërave të Zeza (DPFUUZ):

“DPFUUZ Nr. 5 – Unifikimi i tarifave: **Për secilën kategori të konsumatorëve tarifat janë uniforme në të gjithë zonën shërbyese të një KRU.** Kjo përfshinë tarifat e ujit dhe ujërave të zeza dhe poashtu tarifat fikse. Ky parim aplikohet poashtu për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza posa të ofrohen nga KRU”.

ZRRUK ka shprehur brengosjen që popullata e shërbyer nga infrastruktura e grumbullimit të ujërave të zeza (kanalizimet) por që ndodhet jashtë mbulimit të shërbimit të ITUZ të planifikuar mund të kundërshtoj të paguaj për kostot e trajtimit të ujërave të zeza përmes aplikimit tarifës uniforme. Kjo në anën tjetër, mund të ndikoj në objektivin e përgjithshëm për të rritur mbledhjen e të ardhurave dhe të dëmtoj qëndrueshmërinë financiare të KRU, në veçanti zhvillimin e sektorit të trajtimit të ujërave të zeza.

Sekretariati i KNMU iu përgjigj kërkesës së ZRRUK dhe Zyrës për Bashkëpunim Zviceran (ZBZ) dhe zhvilloj një draft TeR për një Konsulent Ndërkombëtar për Tarifa me qëllim për të identifikuar dhe për të analizuar legjislacionin, procedurat dhe politikat ekzistuese për përcaktimin e tarifave të ujërave të zeza dhe për daljen me një përfundim definitiv lidhur me një politike tarifore të përshtatshme ose jo të përshtatshme për të paguar shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë, së bashku me rekomandimet.

Skat Consulting Ltd. është kontraktuar tek ZBZ për të ofruar shërbime ndihmëse për Projektin RWSSP V duke përfshirë Mbështetjen për Institucionet Kombëtare- kryesisht për ZRRUK dhe IKSHPK (Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës). Në Dhjetor të vitit 2014 SKAT është mandatuar nga ZBZ për të marrë përgjegjësinë e finalizimit të draftit të TeR, duke prokuruar stafin e nevojshëm për të kryer detyrën dhe për të siguruar rezultate të kënaqshme nga shqyrtimi si pjesë e mandatit ndihmës të tyre të Projektit RWSSP V.

Pas diskutimeve të fundit me Drejtorin e ZRRUK dhe Shefin e Tarifave të ZRRUK dhe më pas me përfaqësuesit e SKAT në fillim të muajit Shkurt 2015, duke marrë parasysh buxhetin e kufizuar dhe nevojën urgjente për shqyrtim, janë vendosur të kryhen këto detyrat kryesore:

Detyrat Kryesore

- Analizimi i politikave dhe legjislacionit për përcaktimin e tarifave për trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë;
- Shqyrtimi i studimeve relevante të fizibilitetit²⁸ për trajtimin e ujërave të zeza dhe bërja e krahasimit analitik dhe ndikimi i përcaktimit të tarifës lokale kundrejt asaj uniforme;
- Paraqitja e përfitimeve dhe dëmeve tëqasjes ekzistuese së tarifës uniforme duke përfshirë analizat e përballueshmërisë dhe gatishmërisë për të paguar faturat që rezultojnë nga aplikimi i qasjes së përcaktimit të tarifës së ujërave të zeza në gjithë zonën e shërbimit të KRU;
- Ndërmarrja e një krahasimi bazik i qasjeve të ndryshme të përcaktimit të tarifave të ujërave të zeza në rajon ²⁹ dhe përmbledhja e atyre mësimave të nxjerra;
- Prezantimi i gjetjeve dhe draft rekomandimeve³⁰ në një tryezë të rrumbullakët në fund të detyrës dhe;
- Përgatitja e një Raporti Final të shkurtër (max 30 faqe plus Shtojcat) duke përmbledhur rezultatet e shqyrtimit dhe duke përfshirë rekomandimet kryesore.

Dokumentet kryesore që dorëzohen

Konsulenti do i raportojë ZBZ përmes ekipit ndihmës të SKAT, dhe do ofrojë:

- Një draft raport dhe një prezantim në *Powerpoint*, brenda 3 javëve të fillimit të detyrës, për diskutim dhe aprovim në mbledhje, në një tryezë të rrumbullakët, e cila mendohet të mbahet në mes të muajit Maj 2015.
- Një raport përfundimtar brenda 2 javëve të tryezës së rrumbullakët, pas përfundimit të kontratës, i cili përmban të gjitha gjetjet, elementet e përgatitura, konkluzionet dhe rekomandimet që rezultojnë nga puna e kryer.
- Dokumentin e Përditësuar të Politikës Tarifore për Ujë dhe Ujëra të Zeza.

ZRRUK do ndihmoj konsulentët në identifikimin dhe kontaktimin e palëve të interesuara³¹, dhe poashtu në organizimin e një tryeze të rrumbullakët në fund të detyrës.

Të gjitha raportet dhe dokumentet tjerat duhet të jenë në gjuhën Angleze dhe Shqipe.

²⁸ Përfshirja e Studimeve të Fizibilitetit të SECO të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për Gjakovë (2012) dhe Pejë (2013)

²⁹ psh për ITUZ Skënderaj, në Kosovë dhe ITUZ Durrës, në Shqipëri.

³⁰ Përfshirja e rekomandimeve konkrete për mënyrën se si KRU dhe palët tjera të interesit, përfshirë këtu edhe ZRRUK, mund të përmirësojnë angazhimin e tyre me konsumatorët shtëpiak dhe rrisin ndërgjegjësimin për çështjet ereduktimit të ndotjes së mjedisit duke u bazuar në Parimin "Ndotësi Pague", në mënyrë që të adresohen çështjet kyçe të përballueshmërisë dhe gatishmërisë që rezultojnë nga tarifa më të larta për shërbimet e ujërave të zeza.

³¹ Përfshirja e ERRU në Shqipëri.

SHTOJCA B: FLETA E POLITIKËS SË DIALOGUT PËR TARIFAT UNIFORME RAJONALE TË UJËRAVE TË ZEZA NË KOSOVË

Spektori, Vendi	Ujë, Kosovë
Subjekti	Tarifat Uniforme Rajonale për Ujë
Sfondi	Tarifat uniforme rajonale të ujërave të zeza janë një politikë e integruar brenda kornizës së përgjithshme të përcaktimit të tarifave të Politikës Tarifore të ZRRUK për Shërbimet e Ujësjetlësit dhe Shërbimet e Ujërave të Zeza, që nga Dhjetori 2008. Politika tarifore e Marsit 2011 ka ruajtur të njëjtën politikë. Propozimi ka qenë të mbahet kjo praktikë derisa të arrihen mekanizma më të mirë raportues financiar dhe teknik që më pas do mund të përshpejtonin një analizë më të detajuar. Sidoqoftë, tarifat uniforme rajonale janë parë si mjete të vlefshme për të siguruar përballueshmërinë e shërbimeve dhe për të shmangur tarifën diskriminuese në të njëjtën zonë shërbimi. Psh varësisht nga madhësia e konsumatorëve dhe organizimi teknik, disa komuna (konsumatorë) kanë rrezikuar të paturit e tarifave në mënyrë të konsiderueshme më të larta, nëse trajtohen veç e veç.
Objektiva	1. Pranimi dhe zbatimi i tarifave uniforme rajonale të ujërave të zeza
Statusi aktual (që prej 2014)	Zbatimi i tarifave uniforme rajonale të ujit brenda secilës zonë shërbimi të KRU kërkohet të bëhet sipas Politikës Tarifore (Deklarata e Politikës për Furnizim me Ujë dhe Shërbime të Ujërave të Zeza Nr. 5 "Unifikimi i Tarifave"). Ekziston një periudhë tranzicioni e paraparë prej jo më shumë se tre vjet, pasi që infrastruktura e ujërave të zeza është rishtazi e transferuar në pronësinë/ menaxhimin e KRU. Politika Tarifore poashtu thekson që konsumatorët pa kyqje në kanalizim nuk duhet të ngarkohen për shërbime me ujëra të zeza (Deklarata e Politikës për Furnizim me Ujë dhe Shërbime të Ujërave të Zeza Nr. 4 "Strukturat e Tarifave të Furnizimit me Ujë dhe të Shërbimeve të Ujërave të Zeza"). Prandaj, konsumatorët të cilët nuk janë të lidhur në një sistem të kanalizimit të menaxhuar nga një KRU aktualisht nuk paguajnë tarifa për ujëra të zeza. Megjithatë, për këta konsumatorë duhet aplikuar tarifën e shkarkimit të ujërave të zeza (Shihni Dialogun e Politikës "Tarifa e Shkarkimit të Ujërave të Zeza").
Statusi Aktual (që prej ...)	
Palët kyçe të interesit dhe Rolet/ Përgjegjësitë e tyre	<u>ZRRUK</u>: Llogaritja e tarifave uniforme rajonale të ujit dhe ujërave të zeza, duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të mbulimit të kostos dhe përballueshmërisë së tarifës; Zbatimi i tarifave uniforme rajonale; <u>KRU</u>: Faturimi dhe arkëtimi sistematik i tarifave uniforme rajonale të ujit; <u>KNMU</u>: Kordinon Ministrinë e përfshira (MMPH, MAPL, MZHE, MIE, MeF dhe tjerat Ministri me temat pezull dhe ofron mendime dhe rekomandime për zbatimin e ligjeve dhe akteve nën-ligjore lidhur me menaxhimin e ujit dhe zgjidhjen e politikës financiare në fushën e ujit në përputhje me Nenin 17 të Ligjit të Ujit të Kosovës). Në mënyrë indirekte kjo mund t'i referohet tarifave uniforme të ujit dhe tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza.

	<u>SHUKOS:</u> Rritja e ndërgjegjësimit publik për tarifën uniforme rajonale të ujit.
Ndërfaqja / Nevoja për Koordinim	<u>Ndërfaqësimet me iniciativat dhe projektet e lidhura:</u> • Elaborimi dhe implementimi i udhëzimit administrativ për abstragimin e ujit dhe shkarkimin e ujërave të zeza nga MMPH <u>Ndërfaqësimet për tjerat çështje kyçe të Dialogut të Politikës:</u> • Tarifa për Shkarkimin e Ujërave të Zeza • Ballafaqimi me Tarifën e papërbalueshme për të varfërit • Rritja e Efikasitetit të Arkëtimit
Masat rekomanduara	e Zbatimi dhe fuqizimi i tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza është i rëndësishëm për të promovuar parimin ndotësi paguan dhe për të rritur pranimin e tarifave uniforme rajonale për ujërat e zeza. Tarifa për shkarkimin e ujërave të zeza duhet të përfshihet në materialin informues për rritjen e ndërgjegjësimit: • ZRRUK monitoron promovimin koherent, implementimin dhe fuqizimin e tarifave uniforme rajonale të ujërave të zeza dhe tarifën e shkarkimit të ujërave të zeza dhe ofron rekomandime. • KNMU monitoron progresin lidhur me elaborimin dhe implementimin e udhëzimit administrativ për tarifën e shkarkimit të ujërave të zeza nga MMPH. • SHUKOS në koordinim me palët tjera (KRU, Komisionin Konsultativ për Klientin (KKK) dhe ZRRUK) elaboron materialin informues për publikun, i cili mund të shpërndahet nga KKK dhe të publikohet në uebfaqet e SHUKUS, e KRU dhe e ZRRUK.

SHTOJCA C: FLETA E DIALOGUT TË POLITIKËS PËR TARIFËN E SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA

Spektori, Vendi	Ujë, Kosovë
Subjekti	Tarifa për Shkarkimin e Ujërave të Zeza
Sfondi	Duke u bazuar në parimin që ndotësi paguan (Ligji i Ujërave të Kosovës Nr. 04/L-147) konsumatorët e ujit që shkarkojnë ujërat e zeza të patrajtuara të tyre në mjedis, duhet të paguajnë një tarifë për shkarkimin e ujërave të zeza. Zbatimi dhe fuqizimi i tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza është e rëndësishme për rritjen pranimi të tarifës uniforme rajonale të ujërave të zeza dhe për promovimin e parimit ndotësi paguan (siç përkufizohet në Nenin 6 të Ligjit e Kosovës mbi Ujërat Nr. 04/L-147).
Objektiva	1. Krijimi dhe fuqizimi i legjislacionit sekondar lidhur me tarifën e shkarkimit të ujërave të zeza 2. Faturimi dhe arkëtimi i tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza në koordinim me KRU
Statusi aktual (që prej 2014)	Udhëzimi Administrativ i Qeverisë Nr. 06/2006, i sponsorizuar nga MMPH, rregullon çështjet e abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza dhe poashtu kushtet për pagesën e ngarkesës përkatëse. MMPH ka shqyrtuar udhëzimin administrativ dhe procedura aprovuese është pezulluar për shkak të riorganizimit të Qeverisë, pas zgjedhjeve të përgjithshme të fundit. Tarifat e abstragimit të ujit prej 0.001 Euro/m³ aplikohen pjesërisht për KRU, tek konsumatorët e mëdhenjë të ujit (psh prodhuesit e ujit mineral). Tarifat e shkarkimit të ujërave të zeza (0.001 EUR/m³) nuk janë të zbatuara nga MMPH. Situata aktuale lidhur me zbatimin e tarifës së abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza do përshkruhet në më shumë detaje në Strategjinë e Ujërave.
Statusi Aktual (që prej ...)	
Palët kyçe të interesit dhe Rolet/ Përgjegjësitë e tyre	<u>MMPH:</u> Zbatimi i udhëzimit administrativ për skemën e ngarkimit për përdorimin e ujit <u>MZHE:</u> Nuk është i qartë roli lidhur me përdorimin e të ardhurave nga tarifa e abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza. Të ardhurat nga tarifat e shkarkimit të ujit duhet parimisht të investohen në infrastrukturën e ujërave të zeza dhe ndërgjegjësimi publik. <u>KNMU:</u> Mbështetja dhe lehtësimi i implementimit të tarifave të abstragimit të ujit, tarifave të shkarkimit të ujërave të zeza dhe tarifave uniforme rajonale të ujërave të zeza. <u>SHUKOS:</u> Rritja e ndërgjegjësimi publik për parimin ndotësi paguan dhe për tarifat uniforme rajonale për ujërat e zeza dhe tarifat e shkarkimit të ujërave të zeza. <u>KRU:</u> Faturimi dhe arkëtimi sistematik i tarifave uniforme rajonale të ujit (dhe pagimi i rregullt i tarifave të abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza, tek MMPH).

Ndërfaqja / Nevoja për Koordinim	<u>Ndërfaqësimi me tjerat çështje kyçe të Dialogut të Politikës:</u> • Tarifat Uniforme Rajonale të Ujit • Ballafaqimi me Tarifa të papërballueshme për të varfërit • Rritja e Eficiencës së Arkëtimit
Masat e rekomanduara	• Promovimi, implementimi dhe fuqizimi i tarifës së shkarkimit të ujërave të zeza duhet të lehtësohet/ monitorohet nga MMPH: KNMU duhet të intervenoj për të përsheptuar zbatimin e duhur, aty ku është e mundshme, dhe të punoj me ministrinë e përfshira (MMPH, MBPZHR, MZHE, MeF) dhe palët e interesit (ZRRUK, SHUKOS, AKK) për të finalizuar shqyrtimin (në pritje të vendimit të përditësuar të këtij Kabineti Alnew) e udhëzimit administrativ për përdorimin e ujit; kordinimi me ZRRUK drejtë implementimit të tarifës uniforme rajonale; sigurimi që rolet dhe përgjegjësitë për implementimin dhe fuqizimin e tarifave të abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza janë të përcaktuara qartazi. • Implementimi dhe fuqizimi i tarifës së abstragimit të ujit dhe shkarkimit të ujërave të zeza sipas udhëzimit administrativ të Qeverisë të sponsorizuar nga MMPH. • Në mënyrë që të fuqizoj në mënyrë të duhur një skemë tarifore (të çfarëdo lloji), MMPH duhet të operojë në mënyrë të duhur sistemin e lejeve (abstragimin dhe shkarkimin). Të gjitha abstragimet dhe shkarkimet e rëndësishme duhet të jenë subjekt i një license nga MMPH. Në bazë të kësaj license duhet të zbatohen edhe ngarkesat (aktualisht, duket se një pjesë e mirë e abstraksioneve është e licensuar, ndërsa për shkarkimet e ujërave të zeza vetëm një pjesë e vogël).

SHTOJCA D: TARIFAT E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA NË NDËRMARRJET E UJËSJELLËSIT NË SHQIPËRI: 2014

Tarifat aktuale për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujëra të ndotura
(të dhënat janë rifreskuar në datë 30 shtator 2014)

Lloji i shoqëris	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të	Për Ujin e pijshëm lek/m3			Tarife shërbimi			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			F	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha UK	Berat - Kuçovë	01/06/2014	44	125	125	100	200	200	12	20	20
Sha U	Bilisht (Devoll)	01/01/2012	38	100	110	50	50	50			
Sha U	Bulqizë	01/01/2013	17	55	75	100	100	100			
Sha U	Burrel (Mat)	01/01/2006	23	60	80				2	4	6
Sha UK	Delvinë	01/06/2008	48	100	100						
Sha U	Divjake										
Sha UK	Durrës	01/06/2013	58	110	120	100	100	100	35	50	50
Sha UK	Elbasan (Elber)	01/01/2006	38	115	130				8	25	30
Sha U	Elbasan Fshat	01/01/2013	36	110	110	100	100	100			
Sha U	Ersekë	01/01/2014	35	90	110	100	100	100	8	12	18
Sha UK	Fier	01/05/2014	52	105	125	200	200	200	13	18	20
Sha UK	Fushë Arrez										
Sha UK	Fushë Krujë	01/03/2005	28	60	80				6	10	12
Sha UK	Gjirokastër	01/01/2014	39	112	124	80	80	80	9	14	14
Sha U	Gjirokastër Fshat	01/07/2010	25	60	60						
Sha U	Gramsh	01/01/2011	32	90	90						
Sha U	Has										
Sha UK	Himare										
Sha UK	Kavajë	01/07/2010	38	80	100				15	20	20
	Këlcyre	01/01/2012									
Sha UK	Korçë	01/01/2014	65	110	140	120	120	120	34	56	56
Sha U	Korçë Fshat										
Sha U	Kraste	01/07/2007	30	80	100				7	10	15
Sha UK	Krujë	01/06/2007	33	80	80				8	12	12
Sha U	Kukës	01/10/2004	25	60	80				7	15	20
Sha U	Kurbin	01/01/2011	30	80	120	50	50	50			
Sha UK	Lezhë	01/01/2014	58	135	145	200	200	200	18	22	27
	Libohovë										
Sha UK	Librazhd	01/03/2012	38	100	100				13	22	23
Sha UK	Lushnjë	01/04/2014	54	125	135	100	200	200	15	20	22
Sha U	Lushnjë Fshat	01/01/2006	60	70	100						
	Mallakastër										
Sha U	Malësi e Madhe										
Sha UK	Mirditë (Rreshen)	01/01/2012	30	100	115				10	15	15
Sha U	Novoselë	01/01/2012	33	50	70						
Sha U	Onikum	01/01/2011	25	70	75	100	100	100			
Sha U	Patos										
Sha UK	Peqin	01/07/2010	30	90	100	50	50	50			
Sha U	Permet	01/01/2013	40	110	120	100	100	200			
		1/1/2010 dhe									
Sha U	Peshkopi	01/07/2014	27	65	85				10	15	18
Sha UK	Pogradec	01/01/2013	22/62	37/111	37/111	200+100	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
Sha U	Poliçan	01/07/2010	37	80	95						
Sha UK	Pukë	01/01/2014	35	130	140			100	8	16	16
Sha UK	Pukë Fshat										
Sha UK	Rrogozhinë	01/01/2013	48	90	100	50	100	100	10	12	12
Sha UK	Rubik	01/10/2008	30	70	100				7	10	15
Sha UK	Sarandë	01/01/2014	50	135	135	120	120	120	18	28	28
Sha U	Selenicë	01/07/2010	30	80	100						
Sha UK	Shkodër	01/01/2012	40	110	110	100	100	100	15	20	20
Sha U	Shkodër Fshat	01/01/2012	50	120	120						
Sha U	Skraper - Çorovodë	01/03/2010	27	80	95						
Sha U	Tepelenë	01/01/2014	33	100	120	90	400	250	12	20	20
Sha UK	Tiranë	01/01/2012	45	120	135	100	100	100	11	30	35
Sha U	Tropojë	01/11/2004	19	60	80						
Sha U	Ura Vajguore	10/01/2007	40	90	100						
Shpk	Vau i Dejës										
Sha U	Vlorë	01/05/2013	30	60	80				11	13	13

F - Klientë Familjar
B - Klientë Buxhetor
P - Klientë Privat

**SHTOJCA E: PJESEMARRËSIT E TAKIMIT TË
TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT TË DATËS 23
QERSHOR 2015**

Emri i pjesëmarrësve	Institucioni
Christoph Lang	Zyra e ZBZ në Prishtinë
Ardiana Efendija-Zhuri	Zyra e ZBZ në Prishtinë
Premtim Islami	Zyra e KfW në Prishtinë
Baton Begolli	Sekretariati i IMWC
Sami Hasani	Departamenti për Tarifa në ZRRUK
Hysni Feka	Departamenti për Tarifa në ZRRUK
Vebhi Duraku	Departamenti për Tarifa në ZRRUK
Ilir Abdullahu	KRU Prishtina
Besim Baraliu	KRU Hidroregjioni Jugor
Agron Tigani	KRU Hidrodrini
Sihana Asllani	KRU Radoniqi
Faruk Hajrizi	KRU Mitrovica
Faton Franku	RWC Bifurkacioni
Mumin Morina	KRU Hidromorava
Alan Brown	Udhëheqës i Projektit RWSSP V
Graham Cleverly	Konsultant Ndërkombëtar Mbështetës i SKAT
Vera Muhaxhiri	Konsultant vendor i SKAT: Projekti Mbështetës i ZRRUK
Vjosa Morina	Përkthyes